



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës,
Kuvendi i Komunës së Junikut,
Komiteti për Politikë dhe Financa,
Numër: 002/14
Datë: 15.09.2026

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa iu bënë këtë:

FTESE

Për: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa,
Nga: Leonard Ljolluni – Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa,
Lënda: Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa,
Vendi: Salla e takimeve në katin e dytë të Komunës së Junikut,
Data: 18.09.2026, ora 10⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2027,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit ndryshimeve në rregulloren për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve,
4. Shqyrtimi dhe miratimi në lexim të parë i Draft planit për menaxhimin e popullsisë së qenëve,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt rregullore për taksa komunale për vitin 2027 (leximi i parë),
6. Informata lidhur me përgaditjet dhe fillimin e vitit të ri shkollor 2026/2027,
7. Rishqyrtim i vendimit me nr.2-180/4526, për plotësim ndryshim të rregullore për menaxhimin e mbeturinave,
8. Të ndryshme.

Adresa:

Tel.: +383 (0) 49 760 282

<http://ldk.rks-gov.net/junik>



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ruzhdi Shehu, Kryetar i Komunës së Junikut Leonard Llolluni, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erbilin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 15.07.2026 VI-020-111/14
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit Donjeta Cakolli, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	
Lënda:	Kërkesë për Rishqyrtim	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Nr.2-180/4526 për miratimin e plotësim ndryshimeve të projekt rregullore për menaxhimin e mbeturinave

I miratuar më datë: 30.06.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.06.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2026, ka miratuar vendimin Nr.2-180/4526 për miratimin e plotësim ndryshimeve të projekt rregullores për menaxhimin e mbeturinave.

MAPL konstaton se vendimin Nr.2-180/4526 për miratimin e plotësim ndryshimeve të projekt rregullores për menaxhimin e mbeturinave, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, përkatësisht me Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Neni 12 i Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës përcakton se “plotësim ndryshimi i një akti normativ të komunës behet nga akti i njëjtë duke respektuar procedurat ligjore”, andaj plotësim ndryshimi i rregullores për menaxhim të mbeturinave të Komunës së Junikut nuk mund të behet me vendim, por duhet të behet plotësim ndryshim i rregullores.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Junikut duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme në lidhje me këtë vlerësim.

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
 REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
 Ministry of Local Government Administration

Nr. Br. No. 020-111/15
 Data. Datum. Date. 07.08.2026



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za :	Ruzhdi Shehu, gradonačelnik opštine Junik Leonard Lllolluni, predsedavajući Skupštine opštine Junik	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a,	
Od:	Erblin Hetemi, direktor Pravnog odeljenja/MALS	Dana, 15.07.2026. VI-020-111/14
Odgovorni službenici:		
1.Službenik/ca za potvrđivanje procene:	za pravne Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za razmatranje zakonitosti akata opštine i gradonačelnika	
2.Službenik/ca za izradu pravne procene	Donjeta Cakolli, viša službenica za razmatranje zakonitosti opštinskih akata	
Predmet:	Zahtev za reviziju akta opštine Junik	
Vrsta akta:	Odluka	

Poštovani gradonačelnice,
 Poštovani predsedavajući,

U skladu sa članom 8 i 9 Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju opštinskih akata i Uredbe (VRK) br. 03/2026 o postupku administrativnog razmatranja opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom (VRK) br. 04/2026 o oblastima administrativne odgovornosti ministarstava, Ministarstvo administracije lokalne samouprave je prihvatilo na obavezno razmatranje zakonitosti sledeći opštinski akt:

Odluka br.2-180/4526 o odobravanju dopune i izmene necrta uredbe za upravljanje sa smećem
Usvojena dana, 30.06.2026.
Podnešena na razmatranje u MALS-u dana, 30.06.2026.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja opštinskog akta, procenjuje da opštinski akt, u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

OBRAZLOŽENJE

Skupština opštine Junik, na sednici održanoj dana, 30.06.2026. godine, usvojila Odluku br.2-180/4526 o odobrenju dopune i izmene necrta uredbe za upravljanje sa smećem.

MALS, konstatuje da je Odluka br. 2-180/4526 o odobravanju izmene i dopune nacrtu uredbe o upravljanju sa smećem u suprotnosti sa zakonodavstvom na snazi, odnosno sa Uredbom (MALS-a) br. 02/2021 o postupku izrade i objavljivanja opštinskih akata.

Član 12. Uredbe (MALS-a) br. 02/2021 o postupku izrade i objavljivanja opštinskih akata predviđa da se „dopuna i izmena normativnog akta opštine vrši istim aktom, poštujući zakonske procedure“, stoga se dopuna i izmena uredbe o upravljanju sa smećem u opštini Junik ne može izvršiti odlukom, već se mora dopuniti i izmeniti uredbom.

Na osnovu gore navedenih, Skupština opštine Junik, treba preduzeti delatnosti u zakonskom roku, od trideset (30) dana, da revidira i usklađuje akt sa zakonodavstvom na snazi.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.



2-184/4526
30.06.2026



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

HYRËSE - GLAZNA - INCOMING
REPUBLIC OF KOSOVO
GENERAL KOSOVO, VILAS - GENERAL KOSOVO, VILAS
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Municipality of Local Government Administration
Date: 30.06.2026
Date:
Date:
Niveli organizativ: Nr. i Lendës: Vlera:
-VI- 020-111/14

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/36
Datë: 30.06.2026

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të ligjit për vetëqeverisje lokale (Ligji nr.03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i kuvendit të Komunës së Junikut me numër 001/26), nenit 16 paragrafi 9 të rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 paragrafi 8.1 të Rregullores mbi transparencën, ligjin Nr.08/L-071 për ndryshim plotësim të Ligjit Nr.04/L-060 për mbeturinat, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 30.06.2026 nxjerrë:

VENDIM

për miratimin e plotësimit ndryshimeve të projekt Rregullore për menaxhimin e mbeturinave

I. Me këtë vendim miratohen plotësim ndryshimet e rregullore për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Junikut.

II. Plotësim ndryshimet e projekt rregullore nga pika I. e këtij Vendimi, janë të bashkangjitura së bashku me këtë vendim.

III. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anen e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.


IV. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Shërbime publike e Komunës së Junikut.

V. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministries përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në uebfaqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL,
2. Kryetari i Komunës së Junikut,
3. Drejtoria për Shërbime Publike,
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës,
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
Leonard Llojani





REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA	
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Nr. Org. Broj. Jedinica Broj. Unit	DL
Nr. Ifaqeve Broj. Stranica No. pages	-02-
Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	2681-2/26
Data. Datum. Date.	02.06.2026
PRISHTINË/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Për:	Ruzhdi Shehu, Kryetar i Komunës së Junikut Leonard Llojuni, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në MMPH Bajram Kafexholli, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPH
Nga:	Flori Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në MMPH VL 98/26 Data: 01.06.2026
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues vlerësimit ligjor Arta Krasniqi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e Përfaqësimeve Gjyqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendim Nr. 2-180/3155 për miratimin e plotësim ndryshimit të projekt rregullore për menaxhimin e mbeturinave, miratuar nga Kuvendi I Komunës së Junikut

I nderuar kryetar Shehu,
I nderuar kryesues Llojuni

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 14.05.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin Nr. 2-180/3155 për miratimin e plotësim ndryshimit të projekt rregullore për menaxhimin e mbeturinave, miratuar nga Kuvendi I Komunës së Junikut

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal së Junikut

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimin Nr. 2-180/3155 për miratimin e plotësim ndryshimit të projekt rregullores për menaxhimin e mbeturinave, miratuar nga Kuvendi I Komunës së Junikut

ARSYETIMI

MMPH, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë dhe në pajtim me nenet 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, ka konstatuar se:

Në preambulë të vendimit duhet të shtohet Ligji Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina.

Kurse sa i përket ngritjes së tarifave nuk kemi koment, për shkak se dispozitat e Ligjit për Mbeturina nuk e përcaktojnë vlerën e tarifës apo ngritjen e tarifës mirëpo këtë të drejtë apo kompetencë se si ta kalkuloj dhe përcaktoj tarifën e shërbimit publik për grumbullimin e mbeturinave e kanë komunat dhe si proces i tillë MMPH nuk ndërhyr në këtë çështje.

Nga ajo që u tha më lartë, të vepohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPH, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Ligjit Nr. 08/ L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave.



Buxheti i Komunës së Junikut për vitin 2027 -

Tabela 4.1 (Projekt) Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2027

Kod.	Komun	Kod.i progra mit/nen progra	Prog ram	Nën- program	Përshkrimi	Stafi 2027	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencione t dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total Buxheti 2027
636	Junik				TOTAL SHPENZIME	206	1,955,640	261,400	63,400	70,000	189,034	2,539,474
					Grantet Qeveritare	206	1,955,640	256,400	63,400	35,000	35,439	2,345,879
					Të hyrat vetanake		-	5,000	-	35,000	153,595	193,595
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.1	160				Zyra e Kryetarit	11	129,090	12,200	150	40,000	-	181,440
					Grantet Qeveritare	11	129,090	12,200	150	20,000	-	161,440
					Të hyrat vetanake		-	-	-	20,000	-	20,000
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.1.1	16020				Zyra e Kryetarit	11	129,090	12,200	150	40,000	-	181,440
					Grantet Qeveritare	11	129,090	12,200	150	20,000	-	161,440
					Të hyrat vetanake		-	-	-	20,000	-	20,000
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.2	169				Zyra e Kuvendit Komunal	15	156,787	4,000	-	-	-	160,787
					Grantet Qeveritare	15	156,787	4,000	-	-	-	160,787
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	-
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.3	163				Administrata dhe personeli	12	102,692	27,300	8,000	-	-	137,992
					Grantet Qeveritare	12	102,692	27,300	8,000	-	-	137,992
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	-
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.3.1	16320				Administrata	12	102,692	27,300	8,000	-	-	137,992
					Grantet Qeveritare	12	102,692	27,300	8,000	-	-	137,992
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	-
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.6	175				Buxheti dhe financat	9	92,694	8,300	200	-	-	101,194
					Grantet Qeveritare	9	92,694	8,300	200	-	-	101,194
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	-
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.6.1	17520				Buxheti	9	92,694	8,300	200	-	-	101,194
					Grantet Qeveritare	9	92,694	8,300	200	-	-	101,194
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	-
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.7	180				Shërbimet publike, mbrojtja civile,	8	83,492	50,000	30,950	-	-	164,442
					Grantet Qeveritare	8	83,492	50,000	30,950	-	-	164,442
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	-
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.7.1	18020				Infrastruktura rugore	8	83,492	50,000	30,950	-	-	164,442
					Grantet Qeveritare	8	83,492	50,000	30,950	-	-	164,442
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	-
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.8	195				Zyra komunale për komunitete dhe	1	10,047	-	-	-	-	10,047
					Grantet Qeveritare	1	10,047	-	-	-	-	10,047
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	-
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.10	480				Zhvillimi ekonomik	9	68,670	9,300	500	-	125,841	204,311
					Grantet Qeveritare	9	68,670	9,300	500	-	15,439	93,909
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	110,402	110,402
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.10.1	48020				Planifikimi i zhvillimit ekonom	9	68,670	9,300	500	-	125,841	204,311
					Grantet Qeveritare	9	68,670	9,300	500	-	15,439	93,909
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	110,402	110,402
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.14	660				Planifikimi urban dhe mjedisi	6	70,244	26,500	-	-	43,193	139,937
					Grantet Qeveritare	6	70,244	26,500	-	-	15,000	111,744
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	28,193	28,193
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.14.1	66405				Planifikimi urban dhe inspeksi	6	70,244	26,500	-	-	43,193	139,937
					Grantet Qeveritare	6	70,244	26,500	-	-	15,000	111,744

				Të hyrat vetanake				-	-	28,193	28,193
				Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.15	730	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale			54	495,304	60,500	12,300	-	10,000	578,104
				Grantet Qeveritare	54	495,304	55,500	12,300	-	5,000	568,104
				Të hyrat vetanake		-	5,000	-	-	5,000	10,000
				Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.15.1	73025	Administrata			2	26,074	2,800	-	-	-	28,874
				Grantet Qeveritare	2	26,074	2,800				28,874
				Të hyrat vetanake						-	-
				Financimi i jashtëm						-	-
1.15.2	74200	Shërbimet e shëndetësisë prima			50	453,143	55,300	10,000	-	10,000	528,443
				Grantet Qeveritare	50	453,143	50,300	10,000		5,000	518,443
				Të hyrat vetanake			5,000			5,000	10,000
				Financimi i jashtëm						-	-
1.15.4	75595	Shërbimet sociale			2	16,087	2,400	2,300	-	-	20,787
				Grantet Qeveritare	2	16,087	2,400	2,300		-	20,787
				Të hyrat vetanake						-	-
				Financimi i jashtëm						-	-
1.16	760	Pagesat për performancë në shërbime			-	-	-	-	-	-	-
				Grantet Qeveritare						-	-
				Të hyrat vetanake						-	-
				Financimi i jashtëm						-	-
1.18	920	Arsimi dhe shkenca			81	746,621	63,300	11,300	30,000	10,000	861,221
				Grantet Qeveritare	81	746,621	63,300	11,300	15,000	-	836,221
				Të hyrat vetanake	-	-	-	-	15,000	10,000	25,000
				Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.18.1	92100	Administrata			5	51,958	2,900	-	-	-	54,858
				Grantet Qeveritare	5	51,958	2,900				54,858
				Të hyrat vetanake						-	-
				Financimi i jashtëm						-	-
1.18.2	92590	Arsimi parashkollor dhe qerdh			11	78,471	9,500	-	-	-	87,971
				Grantet Qeveritare	11	78,471	9,500				87,971
				Të hyrat vetanake							-
				Financimi i jashtëm							-
1.18.3	93570	Arsimi fillor			47	438,400	34,900	6,500	30,000	10,000	519,800
				Grantet Qeveritare	47	438,400	34,900	6,500	15,000	-	494,800
				Të hyrat vetanake		-	-	-	15,000	10,000	25,000
				Financimi i jashtëm						-	-
1.18.4	94770	Arsimi I mesëm			18	177,792	16,000	4,800	-	-	198,592
				Grantet Qeveritare	18	177,792	16,000	4,800			198,592
				Të hyrat vetanake							-
				Financimi i jashtëm						-	-

Tabela 4.2 (Projekt) Financimi vjetor i investimeve kapitale komunale për vitin 2027

Total							Kostoja Totale	Transferet qeveritare	Të hyrat vetanake
636	Junik	TOTALE SHPENZIMET KAPITALE					189,034.00	35,439.00	153,595.00
	920	Arsimi dhe shkenca					10,000	-	10,000
	93571	Arsimi fillor					10,000	-	10,000
						Rregullimi i infrastrukturës së oborrit të SHFMU E. Hoxha Faza II	10,000		10,000
							-		
							-		
	480	Zhvillim Ekonomik					125,841	15,439	110,402
	48020	Planifikimi i zhvillimit ekonomik					125,841	15,439	110,402
						Bashkëfinancimi i projekteve	98,841	8,439	90,402
						Ndërtimi i kanaleve të ujitjes Qender, Qok, Miroc, Gacafer, Berishë, 7 SHTATORI	27,000	7,000	20,000
							-		
							-		
							-		
	180	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca					-	-	-
	18020	Infrastruktura rrugore					-	-	-
							-		
							-		
							-		
							-		
	660	Planifikimi urban dhe mjedisi					43,193	15,000	28,193
	66405	Planifikimi urban dhe inspeksioni					43,193	15,000	28,193
						Kanalizimi i ujrave të zeza lokacioni Qender, Gaxherr I ulet, Pepsh, Berishe, Kallavaj	23,193	10,000	13,193
						Rekonstruimi I rruges Shkelzen Gacaferi Faza II	20,000	5,000	15,000
							-		
	163	Administrata dhe Personeli					-	-	-
	16320	Administrata					-	-	-
							-		
	730	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale					10,000.00	5,000.00	5,000.00
	74200	Shërbimet e shëndetësisë primare					10,000.00	5,000.00	5,000.00
						Ndërtimi i garazhave për autoambulanca në QKMF	10,000.00	5,000.00	5,000.00

Tabela 4.2 Financimi vjetor i investimeve kapitale komunale për vitin 2028

Total							Kostoja Totale	Transferet qeveritare	Të hyrat vetanake
636	Junik	TOTALE SHPENZIMET KAPITALE					202,939.00	45,536.00	157,403.00
	920	Arsimi dhe shkenca					10,000	2,000	8,000
	93571	Arsimi fillor					10,000	2,000	8,000
						Rregullimi i infrastrukturës së oborrit të SHFMU E. Hoxha Faza II	10,000	2,000	8,000
							-		
	480	Zhvillim Ekonomik					77,939	9,536	68,403
	48020	Planifikimi i zhvillimit ekonomik					77,939	9,536	68,403
						Bashkëfinancimi i projekteve	77,939	9,536	68,403
							-		
							-		
	180	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca					30,000	4,000	26,000
	18020	Infrastruktura rrugore					30,000	4,000	26,000
						Fushe e hapur dhe kendi I lojrave per femije ne lagjen Berishe	30,000	4,000	26,000
							-		
							-		
							-		
	660	Planifikimi urban dhe mjedisi					70,000	20,000	50,000
	66405	Planifikimi urban dhe inspeksioni					70,000	20,000	50,000
						Rekonstruimi I rruges Shkelzen Gacaferi Faza II	70,000	20,000	50,000
							-		
	730	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale					15,000.00	10,000.00	5,000.00
	74200	Shërbimet e shëndetësisë primare					15,000.00	10,000.00	5,000.00
						Ndertimi i garazhave per autoambulanca ne QKMF	15,000.00	10,000.00	5,000.00

Tabela 4.2 Financimi vjetor i investimeve kapitale komunale për vitin 2029

[illegible]



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

REFERENC-Ë:	Nr. I – 09/20/26
DATE/A:	11.09.2026
PËR/ZA/TO:	z.Leonard Llofuni – Kryesues i Kuvendit Komunal
CC:	z.Ruzhdi Shehu – Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	z.Demokrat Ganijaj – Drejtor për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë



I nderuar,

Bazuar në nenin 62 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, kërkojmë që të futet si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe të Kuvendit Komunal, shqyrtimi në lexim të parë i DRAFT PLANIT PËR MENAXHIMIN E POPULLSISË SË QENVE.

Bashkëngjitur me këtë kërkesë gjeni draft planin e lartëcekur.

Me respekt!



DRAFT PLAN PËR MENAXHIMIN E POPULLSISË SË QENVE

Përgatitur nga Komuna e Junikut në bashkëpunim me:

FOUR PAWS International • **Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve**

Bazuar në ushtrimet komunale të një sesioni pune me Komunën e Junikut, 2026

Kosovë - 2026

FJALOR I TERMAVE DHE SHKURTESAVE

Termi	Përkufizimi
AUVK	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës
FDK	Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve
ICAM	Koalicioni Ndërkombëtar për Menaxhimin e Kafshëve Shoqëruarë — komizë për MPQ të bazuar në dëshmi
KSVL	Kap-Sterilizo-Vaksino-Lëshoj — metoda kryesore humane për menaxhimin e popullsisë së qenve në rrugë
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MSPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MPQ	Menaxhimi i Popullsisë së Qenve
Shkalla e sterilizimit	Përqindja e popullsisë së vlerësuar të qenve në rrugë që është sterilizuar
SMART	Specifik, i Matshëm, i Arritshëm, Relevant, i kufizuar në kohë — kritore për objektiva të formuluar mirë
WOAH	Organizata Botërore për Shëndetin e Kafshëve

PËRMBAJTJA

1	HYRJE	4
1.1	Qëllimi i këtij draft-planit	4
1.2	Baza ligjore	4
1.3	Strategjia Kombëtare për MPQ	5
1.4	WOAH Kapitulli 7.7 — Kontrolli i popullsisë së qenve endacakë	5
2	PROFILI KOMUNAL I MENAXHIMIT TË POPULLSISË SË QENVE	6
2.1	Informata të përgjithshme komunale	7
2.2	Të dhëna për popullsinë e qenve në rrugë	7
2.3	Shpenzimet komunale për MPQ	7
3	DRAFT-PLANI LOKAL PËR MENAXHIMIN E POPULLSISË SË QENVE	7
3.1	Sfidat kryesore	8
3.2	Dinamika dhe rrjedhat e popullsisë së qenve në Junik	8
3.3	Hartëzimi i palëve të interesit	9
3.4	Pema e problemit dhe pema e zgjidhjes	9
3.5	Monitorimi dhe vlerësimi	10
3.6	Planet e MPQ dhe shërbimet e MPQ	10
3.7	Objektivat	11
3.8	Plani i intervenimit	12
3.9	Plani buxhetor	13
4	PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME	12
5	SHTOJCAT	15
	Shtojca A — Fletët e ushtrimeve (nga sesioni i punës)	13
	Shtojca B — Burimet e të dhënave dhe metodologjia	13

1.1 Qëllimi i këtij draft-plani

Ky Draft Plan për Menaxhimin e Popullsisë së qenve (MPQ) për Komunën e Junikut është hartuar nga një soshion pune i mbajtur me komunën nga Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve, duke ndjekur të njëjtën strukturë dhe ushtrime të përdorura në Serinë e Punëtorëve Komunalë për MPQ në Kosovë (2026), të organizuar nga FOUR PAWS International dhe Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve. Ai synon të ofrojë një kornizë për diskutim dhe planifikim komunal rreth një qasjeje humane, të bazuar në dëshmi dhe të qëndrueshme për menaxhimin e popullsisë së qenve në rrugë dhe alyre me pronar.

Plani është hartuar përmes një sesioni pune me pjesëmarrja aktive me përfaqësues të komunës. Draft-plani i bashkon gjetjet, diskutimet dhe ushtritimet e atij sesioni në një kornizë të strukturuar.

Objektivat, synimet, intervenimet dhe buxheti indikativ të paraqitura në këtë dokument duhet të kuptohen si propozime draft-planifikimi që dalin nga sesioni i punës. Ata ofrojnë një bazë për shqyrtim, priorilëzim dhe përmirësim të mëtejshëm nga komuna.

1.2 Baza ligjore

Ky plan bazohet në kornizën ligjore në vijim:

- **Ligji Nr. 2004/21 për Veterinarinë**, Neni 13 — përcakton se autoritetet komunale, në pajtim me procedurat e caktuara nga Ministri, janë përgjegjëse për: (a) regjistrimin e qenve; (b) vaksinimin vjetor kundër tërbimit dhe dehelmintizimin kundër okinokokozës; (c) kapjen e qenve dhe maceve endacake dhe, kur është e nevojshme, cutanazinë e tyre; (d) largimin dhe asgjësimin e sigurt të trupave të tyre; dhe (e) themelimin e objekteve për strehim të qenve dhe maceve, sipas nevojës.
- **Ligji Nr. 02/L-10 për Përkujdesjen ndaj Kafshëve**, Nenet 5 dhe 14 — Neni 5 përcakton se çdo person që mban ose kujdeset për një kafshë është përgjegjës për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e saj, dhe e obligon Ministrinë të nxjerrë akte nënligjore për standardet e kujdesit. Neni 14 parashihet se strehimoret për kafshë endacake dhe me pronar mund të veprojnë vetëm pas marrjes së licencës nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), dhe e obligon Ministrinë të rregullojë licencimin dhe funksionimin e strehimoreve.
- **Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) Nr. 02/2023 për Kushtet dhe Kërkesat Teknike për Strehimoret e Kafshëve Shoqëruese** — udhëzimi administrativ aktual që rregullon standardet e strehimoreve, kërkesat për licencim, KSVL-në dhe kushtet operative për strehimoret e kafshëve në Kosovë (zëvendëson UA 04/2017 të shfuqizuar).
- **Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) Nr. 02/2018 për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve Shoqëruese** — i ndryshuar me UA (MBPZHR) 02/2021, e bën të detyrueshëm mikroçipimin dhe regjistrimin e kafshëve shoqëruese, ndalon braktisjen dhe përcakton dënime për mospëmbushje të obligimeve.
- **Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale**, Neni 17 — përcakton kompetencat votanake të komunave, të cilat përfshijnë shëndetin publik dhe ofrimin e shërbimeve lokale. Së bashku me Ligjin për Veterinarinë, kjo e bazon autoritetin dhe përgjegjësinë komunale për menaxhimin e popullsisë së qenve brenda territorit komunal.

Autoritetet komunale janë institucionet kryesore përgjegjëse për zbatimin e menaxhimit të popullsisë së qenve brenda juridiksionit të tyre, duke përfshirë regjistrimin e qenve, vaksinimin kundër tërbimit, kapjen dhe menaxhimin e kafshëve endacake, themelimin dhe licencimin e strehimoreve, si dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi.

1.3 Strategjia Kombëtare për MPQ

Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Menaxhimin dhe Kontrollin e Qenve me dhe pa Pronarë në Republikën e Kosovës 2022–2028 („Strategjia Kombëtare për MPQ”) është hartuar nën udhëheqjen e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR, Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) dhe Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve. Strategjia koordinon përgjegjësitë ndërmjet institucioneve qendrore dhe lokale për të menaxhuar dhe kontrolluar popullsinë e qenve endacakë dhe me pronar në mënyrë humane dhe të qëndrueshme, të bazuar në dëshmi dhe me një horizont kohor shtatëvjeçar dhe një Plan Veprimi trevjeçar për periudhën 2023–2025.

Strategjia bazohet në gjashtë objektiva strategjiko:

- Zhvillimi i një mjedisi mundësues për MPQ — përfshirë themelimin e një mekanizmi kombëtar ndër-institucional koordinues me veterinerë, ekologë, QJQ dhe autoritete lokale.
- Zhvillimi i një kornize të plotë ligjore — avancimi i legjislacionit për mbajtjen e përgjegjshme, identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve shoqëruarë, kontrollin e mbarështimit dhe shitjes komerciale, si dhe standardet e strehimoreve.
- Edukimi i përgjithshëm shoqëror dhe promovimi i mbajtjes së përgjegjshme — përmes fushatave vetëdijësuese, programeve shkollore dhe angazhimit të komunitetit, me qëllim mbështetjen e praktikave të përgjegjshme të mbajtjes së kafshëve dhe reduktimin e braktisjes dhe sjelljeve të tjera që kontribuojnë në popullsi të pakontrolluara të qenve.
- Kontrolli i riprodhimit të qenve me pronar dhe endacakë, dhe kujdesi veterinar — zbatimi i Kap-Sterilizo-Vaksino-Lësho (KSVL) si masë kyçe kalimtare, së bashku me parandalimin e sëmundjeve dhe kontrollin e sëmundjeve zoonotike.
- Zhvillimi i shërbimeve lokale për menaxhimin e popullsisë së qenve — çdo komunë duhet të hartojë një Program Lokal për Kontrollin e Popullsisë së Qenve (PLKPQ) të përshtatur me dinamikën specifike të popullsisë së qenve, burimet në dispozicion dhe kontekstin e komunitetit.
- Monitorimi dhe vlerësimi — raportim i rregullt në nivel qendror dhe lokal, ku MAPL është përgjegjëse për monitorim gjashtëmuor dhe raportim vjetor për zbatimin e Strategjisë.

Strategjia identifikon katër shkaqe rrënjësore që nxisin rritjen e popullsisë së qenve në rrugë në Kosovë: (1) braktisjen e qenve të padëshiruar nga pronarët; (2) mbarështimin dhe shitjen komerciale të pakontrolluar të qenve; (3) importin ilegal të kafshëve shoqëruarë nga vendet fqinje; dhe (4) riprodhimin e vazhdueshëm të qenve endacakë të pastertilizuar. Trajtimi i këtyre faktorëve themelorë, në vend të fokusimit vetëm te numri aktual i qenve endacakë, është parim themelor i qasjes kombëtare.

Sipas Strategjisë Kombëtare për MPQ dhe Planit të saj të Veprimit, të 38 komunat e Kosovës obligohen të hartojnë Programet e tyre Lokale për Kontrollin e Popullsisë së Qenve (PLKPQ). Kjo përfshin realizimin e vlerësimeve lokale të popullsisë së qenve, hartimin e programeve të MPQ të përshtatura lokalisht dhe pjesëmarrjen në punëtorë rajonalë të koordinuara nga MAPL. Komunitetet janë institucionet kryesore përgjegjëse për zbatimin lokal të MPQ, të mbështetura nga AUVK, MBPZHR, Oda e Veterinarëve të Kosovës dhe organizatat e shoqërisë civile.

Ky Draft Plan për MPQ për Komunitetin e Junikut është hartuar si përgjigje ndaj kësaj kornize kombëtare. Draft-planin e përkthen qasjen kombëtare në objektiva dhe intervenime të përshtatura lokalisht, të informuara nga procesi pjesëmarrës i sesionit të punës të zhvilluar në vitin 2026.

1.4 WOAH Kapitulli 7.7 — Kontrolli i popullsisë së qenve endacakë

Kodi i Shëndetit të Kafshëve Tokësore i Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve (WOAH), Kapitulli 7.7, ofron udhëzime të njohura ndërkombëtare për menaxhimin e popullsisë së qenve endacakë. Parimet kryesore të Kapitullit 7.7 që informojnë këtë plan janë:

- Menaxhimi i popullsisë së qenve duhet të bazohet në dëshmi dhe të përshtatet me kontekstin lokal, duke marrë parasysh dinamikën e popullsisë së qenve dhe të njerëzve.
- Metodat vdekjeprurëse nuk kanë dëshmuar se arrijnë reduktim afatgjatë të popullsisë së qenve dhe nuk rekomandohen aty ku ekzistojnë alternativa humane.
- KSVL, e kombinuar me edukim dhe promovim të mbajtjes së përgjegjshme, është pjesë e një qasje të integruar për menaxhim të qëndrueshëm të popullsisë së qenve.
- Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve qeveritare, shërbimeve veterinarë, organizatave për mirëqenien e kafshëve dhe komuniteteve është i rëndësishëm për MPQ efektive.
- Mbikëqyrja, monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm janë të nevojshëm për të vlerësuar progresin, identifikuar boshllëqet dhe për të përshtatur intervenimet.

PROFILI KOMUNAL I MENAXHIMIT TË POPULLSISË SË QENVE

Ky seksion ofron një pasqyrë të gjendjes aktuale të menaxhimit të popullsisë së qenve në Junik, bazuar në të dhëna të mbledhura nga Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve dhe FOUR PAWS International para serisë së punësorive të vitit 2026.

2.1 Informata të përgjithshme komunale

Futhe e të dhënave	Vendi
Komuna	Junik
Rajoni administrativ	Rajoni i Pejës
Popullsia rezidente	3,943 (Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Regjistrimi 2024)
Gjatësia totale e rrugëve (km)	48.12 km (vetëm rrugë banimi dhe dytësore; Burimi: OpenStreetMap)

2.2 Të dhëna për popullsinë e qenve në rrugë

Të dhëna	Vlera / Vlerësim
Popullsia e vlerësuar e qenve në rrugë	335
Shkalla e sterilizimit	36.4%
Qen për 1,000 banorë	85.0
Qen për km rrugë	2.44

Shënim: Vlerësimet e qenve endacakë janë mbledhur nga FOUR PAWS International dhe Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve. Raporti i plotë është i disponueshëm këtu.

2.3 Shpenzimet komunale për MPQ

Tabela më poshtë përmbledh informacionin për shpenzimet komunale lidhur me shërbimet e menaxhimit të popullsisë së qenve, bazuar në të dhëna të mbledhura përmes kërkesave për qasje në dokumente publiko.

Kategoritë e shpenzimeve	Sëmundje / Shërbime
Shpenzimet totale për MPQ (nga 2008)	Nuk ka të dhëna
Vitet me projekte aktive të MPQ	Nuk ka të dhëna
Viti i të dhënave më të fundit	Nuk ka të dhëna

Shënim: Burimi: Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve — të dhënat për kontratat publike janë mbledhur përmes kërkesave për Qasje në Dokumentet Publike. Shpenzimet e MPQ janë përmbledhur që nga pavarësia, në vitin 2008, megjithatë shpenzimet nuk janë shpërndarë në mënyrë të barabartë ndër vite. Projektet Aktive (kontratat) tregohen sipas viteve në të cilat kanë qenë aktive. Shpenzimet e MPQ përfshijnë masa humanitare dhe jo-humanitare.

DRAFT-PLANI LOKAL PËR MENAXHIMIN E POPULLSISË SË QENVE

Sesioni i punës për MPQ për Junikun u mbajt më 18 gusht 2026 në Komunën e Junikut, i lehtësuar nga përfaqësues të Fondacionit për të Drojtat e Kafshëve. Komuna e Junikut u përfaqësua nga z. Demokrat Ganiqaj dhe z. Besart Tofaj. Qëllimi i tij ishte ta udhëzojë komunën përmes procesit të planifikimit për Menaxhimin e Popullsisë së Qenve (MPQ) dhe të ndërtojë themelin për një strategji të MPQ në pronësi lokale dhe të bazuar në dëshmi.

Seksjonet vijuese përmbledhin ushtrimet e zhvilluara gjatë sesionit të punës nga përfaqësuesit e Komunës së Junikut.

Secili ushtrim paraqitet si rezultat i prodhuar nga pjesëmarrësit komunalë gjatë sesionit të punës.

Sesioni i punës i mbuloi të njëjtat ushtrime tematike të përdorura në të gjithë serinë e punëtorive të vitit 2026, secili duke kombinuar një ushtrim praktik me diskutim. Pjesëmarrësit i përpunuan ushtrimet me radhë, ndërsa rezultatet u regjistruan aty ku u prodhuan.

3.1

SFIDAT KRYESORE

Pjesëmarrësit ndanë dhe diskutuan sfidat kryesore aktuale me të cilat ballafaqohen në menaxhimin e popullsisë së qenve në komunën tuaj.

Rezultati i sesionit të punës — Junik

Sfidat kryesore të identifikuar janë mungesa e kontrollit të qenve me pronar — një pjesë e madhe e të cilëve lëshohen të bredhin lirshëm dhe riprodhohen me qentë që tashmë janë në rrugë — braktisja e lidhur me migrimin e pronarëve jashtë vendit, të cilët i lënë qentë pas, ardhja e qenve nga komuna fqinje, si dhe vetëdija e ulët publike për mbajtjen e përgjegjshme dhe për obligimin ligjor të identifikimit dhe regjistrimit të qenve.

3.2

DINAMIKA DHE RRJEDHAT E POPULLSISË SË QENVE NË JUNIK

Rezultati i sesionit të punës — Junik

Në Junik ka qen me pronar dhe qen në rrugë. Pronarët kryesisht i marrin qentë nga femerët ose nga mbarështues joformalë, ku qentë e Sharrit dhe Kangal janë më të shpeshtët. Një pjesë e madhe e qenve me pronar lëshohen të bredhin lirshëm dhe shumë prej tyre riprodhohen me qentë që tashmë janë në rrugë — duke e bërë riprodhimin e pakontrolluar të qenve me pronar që bredhin lirshëm rrjedhën kryesore hyrëse brenda komunës. Braktisja është rrjedhja e dytë hyrëse, dhe një arsye e raportuar shpesh është migrimi jashtë vendit, ku pronarët i lënë qentë pas. Rrjedhja e tretë vjen nga jashtë komunës: braktisje dhe migrim nga komuna të tjera, sidomos rreth fshatit Shkozë në kufi me Deçanin, në një zonë ish-deponie. Pjesëmarrësit raportuan se në Junik nuk ka këlyshë dhe as femra në laktacion, dhe se në komunë nuk ka trog të kafshëve.

3.3

HARTËZIMI I PALËVE TË INTERESIT

Pjesëmarrësit identifikuan dhe hartëzuan palët e interesit relevante për menaxhimin e popullsisë së qenve, duke i kategorizuar sipas nivelit të ndikimit dhe nivelit të interesimit.

Rezultati i sesionit të punës — Harta e palëve të interesit për Junik

Pala e interesit	Ndikimi (L/M/U)	Interesimi (L/M/U)	Roli / Shënime
Pronarët e qenve	I madh	I vogël	Roli aktual: Shkaktarët e problemit. Roli potencial: Kontrolli i qenve të tyre.
Drejtoria e Bujqësisë	I vogël	I madh	Roli aktual: —. Roli potencial: Kontrolli i qenve në ferma.
Drejtoria e Shërbimeve Publike	I madh	I madh	Roli aktual: Menaxhimi i popullsisë së qenve (MPQ). Roli potencial: Menaxhimi i popullsisë së qenve (MPQ).
Drejtoria e Arsimit	I madh	I madh	Roli aktual: —. Roli potencial: Organizimi i fushatave të vetëdijësimit.
OJQ-të	I madh	I madh	Roli aktual: KSVL. Roli potencial: KSVL; vetëdijësim; monitorim.
Inspektorët e AUV	I madh	I madh	Roli aktual: Kontrolli i qenve me pronar. Roli potencial: Kontrolli i qenve me pronar.

3.4

PEMA E PROBLEMIT DHE PEMA E ZGJIDHJES

Pjesëmarrësit ndërtuan një pemë të problemit (problemi qendror, shkaqet rrënjësore, pasojat) dhe një pemë përkatëse të zgjidhjes (qëllimi, intervenimet, efektet).

Rezultati i sesionit të punës — Pema e problemit dhe e zgjidhjes për Junik

PEMA E PROBLEMIT	PEMA E ZGJIDHJES
Shkaqet rrënjësore Bredhja e lirë e qenve me pronar; Riprodhimi i qenve në rrugë	Intervenimet Subvencionimi i identifikimit dhe regjistrimit; Subvencionimi i vaksinimit për qen të me pronar; Subvencionimi i sterilizimit për qen të me pronar; Vetëdijësimi nga OJQ-të; Koordinimi me komunën dhe Policinë; Vetëdijësimi në shkollë dhe komunitet
Problemi qendror Mungesa e kontrollit të qenve me pronar	Synimi / Qëllimi Vetëdijësimi i njerëzve
Pasojat Me shumë braktisje; Kafshime; Probleme të sigurisë	Efektet Shpërndarja e fletushkave; Vazhdimi i KSVL; Monitorimi dhe kontrolli i qenve me pronar; Vetëdijësimi nga OJQ-të

3.5

MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Pjesëmarrësit identifikuar të dhënë të nevojshme për të monitoruar efektshmërinë e intervenimeve të planifikuara, vlerësuar cilat të dhëna ishin të shumtë në dispozicion dhe diskutuar përgjegjësinë për mbledhjen dhe mirëmbajtjen e tyre.

Rezultati i sesionit të punës — Korniza e MV për Junik

Indikatori	Burimi i të dhënave	Frekuenca	Përgjegjës
Numri i qenve në rrugë	Anketimet në rrugë	1 herë në vit	Komuna: OJQ-të
Përqindja e sterilizimit	Anketimet në rrugë	1 herë në vit	Komuna: OJQ-të
Numri i qenve me pronar	Anketimet në anketim	Çdo 4 vite	Komuna: OJQ-të

Indikatorët dhe frekuencat e mësipërme duhet të rishikohen si pjesë e planifikimit të mëtejshëm, për të konfirmuar që janë praktikë, të matshëm në mënyrë konsistente dhe të mjaftueshëm për të vlerësuar progresin me kalimin e kohës.

3.6

PLANET E MPQ DHE SHËRBIMET E MPQ

Një koncept kyç i prezantuar gjatë sesionit të punës së punës, dhe thelbësor për vendimmarrësit komunalë, është kuptimi se si Plan i Menaxhimit të Popullsisë së Qenve dhe Shërbimet e Menaxhimit të Popullsisë së Qenve funksionojnë së bashku: Plan përcakton drejtimin strategjik, ndërsa Shërbimet janë aktivitetet operative që mbështesin zbatimin e tij.

PLANI I MPQ	SHËRBIMET E MPQ
Dokument strategjik që udhëzon se si komuna do ta menaxhojë popullsinë e saj të qenve gjatë një periudhe të caktuar (zakonisht 3–5 vjet)	Aktivitetet operative që komuna i prokuron ose i ofron për të zbatuar menaxhimin e popullsisë së qenve në terren
Përcakton synime, objektiva dhe cak të matshëm	Përfshin KSVL, regjistrimin, vaksinimin, inspektimet
Identifikon shkaqet rrënjësore dhe zgjedh intervenimet përkatëse	Prokurohen nga operatorë veterinarë, OJQ, ose ofrohen nga vetë komuna
Cakton përgjegjësitë dhe ndan buxhetin ndërmjet intervenimeve	Duhet të udhëhiqen nga Plan i MPQ — jo e kundërta
Përfshin një kornizë monitorimi dhe vlerësimi	Efektshmëria varet nga trajtimi i shkaqeve rrënjësore të identifikuara
Është parakusht për shpenzim efektiv — parandalon intervenimin reaktiv dhe të fragmentuar	Pa një plan, shërbimet priren të jenë afatshkurtra, të pakoordinuara dhe të pamatshme

Pse ka rëndësi ky dallim

Në Kosovë, shumë komuna kanë kontraktuar shërbime të MPQ, zakonisht KSVL dhe funksionim të stacioneve, për disa vite, ndonjëherë pa një strategji të qartë udhëzuese. Një strategji e fortë e MPQ mund të ndihmojë që shpenzimi të jetë më proaktiv, përsëritja e ndërhyrjeve të informohet nga deshmë e disponueshme dhe sfidat themelore të menaxhimit të popullsisë të qenve përparësi krahas menaxhimit të qenve ekzistues në rregull. E shoqëruar me një plan të shkruar, strategjia mund të ofrojë një kornizë për lidhjen e shërbimeve të kontraktuara me objektiva specifike dhe monitorimin nëse aktivitetet e synuara po zhatohen dhe po kontribuojnë në progres.

3.7

OBJEKTIVAT

Objektivat më poshtë burojnë nga ushtrimet dhe diskutimet e sesionit të punës. Ato paraqiten si objektiva draft në stilin SMART dhe duhet të rishikohen e konfirmohen kundrejt të dhënave bazë në dispozicion, kapacitetit komunal, burimeve dhe përgjegjësiwe përkatëse, para miratimit formal.

Objektivat SMART

#	Objektivi (SMART)	Indikatori	Afati kohor	Pala përgjegjëse
1	I&R dhe vaksinimi i qenve me pronar (Synimi: Kontrolli i qenve përmes I&R)	40% të qenve të regjistruar dhe vaksinuar	1 vit	Komuna; OJQ-të
2	Ofrimi i sterilizimit të qenve me pronar (Synimi: Parandalimi i braktisjes së këlyshëve)	30% të qenve të sterilizuar	Çdo vit	Komuna
3	Organizimi i sesioneve shkollorë (Synimi: Organizimi i sesioneve)	Mbulimi i 18 klasave fillore × 3; mbulimi i 9 klasave të mesme × 3	Çdo vit	Komuna; OJQ-të
4	Futja në kurrikulë e edukimit për sjelljen ndaj kafshëve (Synimi: Ngritja e vetëdijes për sjelljen ndaj kafshëve)	1 mësim i aprovuar nga DKA	1–3 vite	Komuna

Objektivat e propozuara më lart janë supozime planifikimi të dalta nga sesioni i punës. Fizibiliteti, kërkesat për burime dhe metodat e matjes duhet të konfirmohen para se të miratohen si angazhime formale komunale.

3.8

PLANI I INTERVENIMIT

Plani i intervenimit i përkthet objektivat e zhvilluara në Seksionin 3.7 në një grup të strukturuar aktiviteteve të propozuara. Çdo intervenim lidhet me një popullsi të synuar të qenve, një palë përgjegjëse, një afat kohor dhe një kontribut të synuar. Intervenimet duhet të rishikohen në mënyrë periodike dhe të përshtaten sipas të dhënave të monitorimit, përvojës së zbatimit, burimeve në dispozicion dhe ndryshimeve në kushtet lokale.

Matrica e intervenimit

Problemi	Shkaku kryesor	Intervenimi	Përgjegjësi	Afati kohor
Shënim i numrit të qenve në rrugë	Riprodhimi pak kontrolluar	KSVL	Komuna; OJQ-të	Çdo vit
Mungesa e informatave për qentë	Mungesa e vetëdijësimit	Organizimi sesioneve edukative	Komuna; OJQ-të	—
Braktisja dhe keqmbajtja	Mungesa e informatave	Organizimi fushatave vetëdijësuese (Indikator: Fletushkat; videot; posterat)	Komuna; OJQ-të	Çdo vit
Braktisja dhe keqmbajtja	Mungesa e informatave për mbajtje të përgjegjshme	Vizita derë më derë tok pronarëve të qenve (Indikator: 30% të shtëpive me pronar të mbuluar)	Komuna; OJQ-të	1 vit
Mungesa e regjistrimit	Mungesa e informatave për obligimet ligjore	I&R i qenve me pronar (Indikator: 30% të qenve me pronar të regjistruar)	Komuna	1–3 vite

3.9

PLANI BUXHETOR

Ky seksion paraqet një buxhet indikativ për zbatimin e planit të intervenimit siç është propozuar nga pjesëmarrësit. Shifrat bazohen në vlerësimet e zhvilluara nga pjesëmarrësit gjatë ushtrimit buxhetor të sesionit të punës, të informuara nga çmimet aktuale të tregut lokal për shërbime veterinarë dhe strehimore.

Të gjitha shumat janë indikative. Ndarja përfundimtare e buxhetit i nënshtrohet procesit vjetor të buxhetimit komunal, kërkesave të prokurimit, financimit në dispozicion dhe miratimit politik.

Pasqyra e buxhetit

Aktiviteti	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Kosto totale	Viti
KSVL	Qen	100	€130	€13,000	Viti 1
Organizimi i sesioneve shkollore	Sesion	86	€50	€4,300	Viti 1
Identifikimi, regjistrimi dhe vaksinimi i qenve me pronar	Qen	100	€35	€3,500	3 vite
Vizita derë më derë	Vizitë	100	€20	€2,000	3 vite
Organizimi i fushatës vetëdijësuese	Fushatë	1	€2,000	€2,000	Viti 1
TOTALI				€24,800	

Supozimet dhe shënimet e buxhetit

- Kostot për njësi të KSVL vlerësohen bazuar në çmimet aktuale veterinarë të caktuara nga Oda e Veterinarëve të Kosovës. Kostot faktike mund të ndryshojnë varësisht nga prokurimi, specifikimet e shërbimit dhe kushtet e tregut.
- Kostot e regjistrimit dhe sterilizimit të qenve me pronar përfshijnë mikroçipin, sterilizimin, pasaportën dhe regjistrimin në bazën e të dhënave.
- Kostot e angazhimit komunitar dhe komunikimit mbulojnë materialet e shlypura, vizitat në shkollë dhe prodhimin e përmbajtjes për rrjetet sociale.
- Shifrat e buxhetit total indikativ bazohen në supozimet e regjistruara gjatë sesionit të punës dhe duhet të rishikohen kundrejt shtrirjes përfundimtare të intervenimit dhe kërkesave komunale të prokurimit, para se të merren angazhime buxhetore.

Burimet e financimit

Buxheti komunal (burimi kryesor) - Mbrojtetja e Qeverisë Qendrore (nëse është në dispozicion)
Fondet IPA / paraanëtarësimi të BE-së - Bashkëfinancim nga OJQ për mirëqenien e kafshëve

4

PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME

Ky Draft Plan për MPQ pasqyron rezultatet e prodhuara nga përfaqësuesit e Komunës së Junikut gjatë sesionit të punës, ku u mbuluan të shtatë ushtrimet themelore. Draft-planit regjistron çfarë identifikuan, priorizuan dhe propozuan pjesëmarrësit në atë moment.

Një plan në vetvete nuk e zvogëlon numrin e qenve. Nëse ky dokument kontribuon në përmirësimin e menaxhimit të popullsisë së qenve varet nga strategjia që komuna zhvillon rreth tij: si renditen, financohen, kontrahohen, zbatohen, përmirësohen dhe monitorohen intervenimet përgjatë viteve buxhetore.

Intervenimet e propozuara synojnë të adresojnë një kombinim të faktorëve të menaxhimit të popullsisë, ofrimit të shërbimeve, faktorëve mjedisorë dhe të sjelljes. Kontributi i tyre në rezultatet afatgjata do të varet nga cilësia e zbatimit, mbulimi, vazhdimësia, reagimi i komunitetit dhe konteksti më i gjerë lokal.

Për të kaluar nga ky draft-plan drejt një strategjie aktive të MPQ, Komuna e Junikut duhet të shqyrtojë sa vijon:

Miratimi formal (Seksioni 3.7): Rishikimi dhe, aty ku është e përshtatshme, miratimi formal i qëllimit dhe objektivave të MPQ, pas konfirmimit të fizibilitetit, relevancës dhe përputhshmërisë së tyre me prioritetet dhe përgjegjësitë komunale.

Renditja dhe financimi (Seksioni 3.8): Vendosja e radhës së mundshme të zbatimit të intervenimeve dhe konfirmimi se kush do të jetë përgjegjës për secilin, duke marrë parasysh kapacitetin dhe burimet në dispozicion.

Kontraktimi i shërbimeve dhe buxheti (Seksionet 3.8 dhe 3.9): Aty ku shërbimet kontraktohen, lidhja e tyre me objektiva dhe kontribute specifike të synuara, duke pasur parasysh vazhdimësinë përgjatë viteve buxhetore në vend të mbështetjes vetëm të kontratave afatshkurtra.

Monitorimi dhe vlerësimi (Seksioni 3.5): Mbledhja e treguesve të dakorduar, rishikimi i tyre në intervalet e përcaktuara dhe përshtatja e intervenimeve aty ku të dhënat e monitorimit tregojnë se aktivitetet nuk po prodhojnë progresin e synuar.

Angazhimi komunitar dhe ndryshimi i sjelljes: Zhvillimi i aktiviteteve të synuara të komunikimit dhe angazhimit roth sjelljeve specifike që kontribuojnë në përmirësimin e MPQ, duke përfshirë mbajtjen e përgjegjshme, regjistrimin, vaksinimin, sterilizimin dhe parandalimin e braktisjes, në vend që të mbështetjet vetëm të vetëdijësimit i përgjithshëm.

Shifrat, objektivat dhe intervenimet në këtë plan janë ato të propozuara nga pjesëmarrësit e sesionit të punës dhe nuk janë validuar në mënyrë të pavarur, as nuk i janë nënshtruar një vlerësimi të detajuar fizibiliteti. Prandaj ato duhet të trajtohen si supozime draft-planifikimi dhe jo si rezultate të garantuara.

FOUR PAWS International dhe Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve mund të vazhdojnë të ofrojnë lehtësim dhe mbështetje teknike, por asnjëra organizatë nuk është përgjegjëse për zbatimin dhe asnjëra nuk mund të garantojë rezultatet e paraqitura këtu. Rezultatet do të varen nga vendimet, financimi, kapaciteti zbatues dhe zbatim, që i takojnë komunës dhe partnerëve të saj, si dhe nga reagimi i komunitetit dhe dinamika më e gjërë e popullsisë.

Prandaj, progresi duhet të vlerësohet përmes komizës së monitorimit dhe të dhënave të tjera relevante të mbledhura me kalimin e kohës, me intervenime të përshtatura aty ku dëshmitë tregojnë se nevojiten ndryshime.

5

SHTOJCAT

Shtojca A — Fletët e ushtrimeve (nga sesioni i punës)

Shtojca B — Burimet e të dhënave dhe metodologjia

Të dhënat komunale në Seksionin 2 janë mbledhur nga FOUR PAWS dhe Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve ndërmjet viteve 2024 dhe 2026 përmes metodave të mëposhtme:

- Të dhënat për kontrata publike janë siguruar nga Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve përmes kërkesave zyrtare sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.
- Vlerësimet e popullsisë së qenve endacakë bazohen në numërimet në terren të kryera nga ekipat e FDK/FOUR PAWS duke përdorur metodologjinë e standardizuar të vrojtimit. Anketimi Kombëtar i Popullsisë së Qenve në Rrugë në Kosovë.
- Të dhënat për gjatësinë e rrugëve të banimit dhe dytësoro janë marrë nga OpenStreetMap.
- Të dhënat për popullsinë janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Regjistrimi i Popullsisë dhe Banorëve 2024.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
01/Nr. Prot.	2- 755 / 7372
Një. Org	2
Nr. i faq.	2
Data	11 / 09 / 2026



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	11.09.2026
PËR/ZA/TO:	z.Leonard Lolluni– Kryesues i Kuvendit Komunal
Nr.	7-28
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	z.Xhavit Velijaj- Drejtori për Arsim, Kulturë, Rini dhe sport (DAKRS)
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informacion për përgatitjet dhe fillimin e vitit të ri shkollor 2026/2027

I nderuar,

Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, në bashkëpunim me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore, gjatë periudhës para fillimit të vitit shkollor ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e procesit edukativo-arsimor.

Në Komunën e Junikut, procesi arsimor zhvillohet në këto institucione:

- Institucioni Parashkollor – “Yjet e Gjeravicës”;
- SHFMU “Edmond Hoxha”;
- Gjimnazi “Kuvendi i Junikut”.

Sa i përket organizimit të procesit mësimor dhe sigurimit të kuadrit, gjatë periudhës së përgatitjeve janë zhvilluar procedurat e rekrutimit për pozitat ku është evidentuar nevoja për personel arsimor në Institucionet Arsimore, përfshirë lëndët:

- Fizikë – SHFMU “Edmond Hoxha”;
- Edukatë fizike – SHFMU “Edmond Hoxha”;
- Gjuhë angleze – SHFMU “Edmond Hoxha”;
- Art figurativ – SHFMU “Edmond Hoxha”;
- Histori – Gjimnazi “Kuvendi i Junikut”.

Për këto pozita është realizuar procesi i rekrutimit.

Në Institucionin Parashkollor “Yjet e Gjeravicës”, për këtë vit vijnë gjithsej 45 fëmijë.

Në SHFMU "Edmond Hoxha", në nivelin parafillor, për këtë vit janë regjistruar 31 fëmijë.

Në klasën e I-rë të nivelit fillor janë regjistruar 20 nxënës, të organizuar në dy paralele. Në kl. X-të, për këtë vit shkollor, nxënës të regjistruar sipas drejtimeve janë:

- Shkenca Natyrore 21 nxënës;
- Shkenca Shoqërore – 19 nxënës;
- Mjekësi 12 nxënës.

Sa i përket furnizimit me tekste shkollore për nxënësit e kl. I-IX, procesi i furnizimit vijon.

Për të gjitha IEA-të është bërë furnizimi me dokumentacion pedagogjik, materiale shpenzuese për higjienë dhe lëndë djegëse, pelet dhe dru për ngrohje.

Në infrastrukturën e IEA-ve është duke u realizuar projekti EFFORT, në kuadër të investimeve të Bashkimit Evropian për efikasitet të energjisë. Ky projekt është në zhvillim e sipër, ku punimet pritet të përfundojnë në fund të muajit shtator të këtij viti. Në projekt janë të përfshira këto punime:

- Vendosja e roleteve të jashtme në dritaret e objektit të IP-së, ku ndikon në uljen e rrezatimit gjatë temperaturave të larta gjatë verës, dhe ndërrimi i kutisë kryesore me të gjitha siguresat elektrike – Institucioni Parashkollor "Yjet e Gjeravicës";
- Vendosja e dy pompave qarkulluese dhe punimi i panelit elektrik në sistemin e ngrohjes dhe izolimi termik i gypave të ngrohjes në kaldatore – Institucioni Parashkollor "Yjet e Gjeravicës";
- Vendosja e paneleve solare për furnizim me energji elektrike të ripërtëritshme, me nga 8 kwh për të gjitha objektet e IEA-ve.

Sfidat:

- Rënia e numrit të nxënësve në IPA;
- Mbingarkesa me personelin arsimor, që reflekton nga rënia e numrit të nxënësve;
- Realizimi i projekteve kapitale për shkak të tërheqjes së mjeteve nga përmbaruesit, të lidhur me kontratën kolektive;
- Si rezultat i ngarkesës energjetike të pajisjeve të kuzhinës akoma nuk është funksionalizuar aneksi i kuzhinës në Institucionin Parashkollor. Si rezultat i kësaj, duhet të investojmë në ndërtimin e trafostacionit elektrik, bashkë me rrjetin furnizues;
- Buxheti i kufizuar në investime në infrastrukturën shkollore.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

(DRAFT)

RREGULLORE KOMUNALE

PËR TAKSAT KOMUNALE

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Junik, Shtator 2026

Në bazë të ligjit për Vetëqeverisje lokale numër 03/L-40, neni 12, pika 12.2 (c) dhe neni 40, pika 40.2 (a), Ligjit për Financat e Pushtetit lokal numër 03/L-049, neni 2 dhe neni 8, Statutit të Komunës së Junikut i datës 29.09.2010, neni 21 pika 21.1 (d), neni 22.1 pika 3 (j) dhe në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi Komunal i Junikut në Mbledhjen e mbajtur me datë 00.00.0000, shqyrtoi dhe miratoi:

RREGULLOREN PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE- PËR VITIN 2027

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

PËRKUFIZIMET

Me qëllim të interpretimit, termet dhe shprehjet në vijim, kurdo që përdoren në këtë rregullore kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë:

- **Taksë** - do të thotë një shumë fikse e cila paguhet për pranimin e një privilegji, leje, dokumenti ose shërbimi profesional. Taksat zbatohen për licenca, leje, dokumentet, shërbime të caktuara ose nevoja të tjera për përmbushjen e të cilave nuk ka shumë ndryshim në masën e përpjekjeve, kohën ose materialet e nevojshme.
- **Ngarkesë** - ka kuptimin e shumës e cila paguhet në emër të ndërtimit apo rrënimit të objekteve, shfrytëzimit të burimeve natyrore, të hyrat nga qiradhënia dhe nga gjobat e trafikut.
- **Gjobë** - do të thotë një pagesë e cila duhet të bëhet në rast të shkeljes së një ligji, rregulle ose rregullore komunale. Në përgjithësi, gjobat shqiptohen me qëllim të dënimit të një shkelje duhet të shqiptohen në përputhje me shumat fikse e cila paguhet në emër të shërbimit që ofrojnë organet komunale.
- **Viti fiskal**- do të thotë periudhën prej 1 Janarit të një viti deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.
- **Buxheti i Konsoliduar i Kosovës ose “BKK”**- do të thotë buxheti gjithë përfshirës i Kosovës për të gjitha organizatat buxhetore.
- **LMFPP**- nënkupton Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
- **Rregullore Komunale**- ka kuptimin e përcaktuar në LVQL –Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.
- **Komuna**- ka kuptimin e përcaktuar në LVQL.
- **Prona komunale**- nënkupton pronën, duke përfshirë pronën e paluajtshme, e cila është ligjërish në pronësinë ose ligjërish nën administrimin e komunës.
- **Të hyrat vetanake**- do të thotë të gjitha shumat e parave publike të cilat janë shqiptuar dhe janë mbledhur në mënyrë të ligjshme nga komuna nga burimet e përcaktuara në Nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-049 (Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë).
- **Ndërmarrje** - do të thotë çdo organ, institucion, shoqatë, ndërmarrje, shoqëri tregtare, person juridik, ose organizatë tjetër.

- **Person fizik** - nënkupton çdo person që është shtetas i Republikës së Kosovës, shtetas i një shteti të huaj, ose person pa shtetësi;
- **Person juridik** - nënkupton një entitet publik ose privat, shoqatë, shoqëri ose organizatë tjetër biznesi që ka statusin e një personi juridik sipas legjislacionit në fuqi mbi shoqëritë tregtare dhe çdo legjislacion tjetër të aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Qëllimi

Me këtë rregullore caktohet lartësia e taksave, tarifave, ngarkesave dhe gjobave për shërbime administrative komunale, lëshimit të dokumenteve publike, përpilimit të shkresave dhe ofrimit të shërbimeve profesionale sipas kërkesës së palëve, tarifave për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit, pronësisë së automjeteve motorike, përdorimit apo shfrytëzimit të pronës komunale, ngarkesave për ndërtimin dhe rrënimin e objekteve, shfrytëzimin e burimeve natyrore, të hyrave nga qiradhënia dhe gjobat nga trafiku, për personat fizik dhe juridik që ushtrojnë aktivitetet në territorin e Komunës së Junikut.

Neni 3

Obliguesit duhet t'i paguajnë ngarkesat dhe taksat sipas Rregullores komunale në xhirollogarinë përkatëse të Komunës me numër 1000650100000085 dhe numër fiskal 600535689, ku pagesa në shumën deri në 10.00€ bëhet drejtpërsëdrejti në arkën e Administratës komunale, ndërsa përmes bankave afariste bëhet pagesa për shumën mbi 10.00€.

Neni 4

Taksat, Ngarkesat, Tarifat dhe Gjobat komunale, me këtë rregullore përcaktohen sipas lëmive përkatëse dhe strukturës organizative të administratës, duke përfshirë numrin rendor si dhe vlerën përkatëse.

Neni 5

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

5.1 TARIFAT E NDRYSHME PËR DHËNIEN E DOKUMENTIT ZYRTAR

1. ÇERTIFIKATAT	ÇMIMI
1.1- Certifikatë e lindjes	1€
1.2- Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile	1€
1.3- Certifikatë e shtetësisë	1€
1.4- Certifikatë e martesës	1€
1.5- Certifikatë e vdekjes	1€
1.6- Certifikatë e vendbanimit	2€
1.7- Certifikatë e gjendjes martesore	3€
1.8- Deklaratë e bashkësisë familjare	2€
1.9- Vërtetim nga arkivi	2€
1.10- Certifikatë e lindjes me fotografi	2€
1.11- Aktvdekja	5€
2. LINDJET	
2.1-Regjistrimi i rregullt i lindjes	2€
2.2- Regjistrimi i rregullt i lindjes-nga bota e jashtme	5€
2.3- Regjistrimi i më vonshëm i lindjes-pas 30/ditëve	20€
2.4-Regjistrimi i shtetasit të RKS mbi moshën 18 vjeç për herë të parë	5€
3. RIREGJISTRIMET	
3.1- Ri regjistrimet në RTHL (Regjistri themeltar i lindjes)	2€
3.2- Ri regjistrimit në RTHV (Regjistri themeltar i vdekjes)	2€
3.3- Ri regjistrimet në RTHM (Regjistri themeltar i martesës)	2€
4. MARTESAT	
4.1- Shpallja e martesës	1€
4.2- Lidhja e martesës në objektin komunal, gjatë orarit zyrtar	10€
4.3- Lidhja e martesave me shtetas të huaj	50€
4.4- Regjistrimi i martesave të lidhura jashtë vendit	10€
4.5-Lidhja e martesës jashtë objektit të Komunës, dhe gjatë Festave	70€
4.6-Deklarata për kthimin e mbiemrit familjar, pas zgjidhjes së martesës	5€
4.7- Proces verbali mbi pranimin e atësisë dhe amësisë	2€
4.8 – Zgjidhja e martesës me Gjykatë	5€
5. VDEKJET	
5.1- Regjistrimi i Vdekjes	2€
5.2 -Regjistrimi i më vonshëm i vdekjes	50€
5.3- Regjistrimi i vdekjes së ndodhur jashtë Kosovës	5€
5.4- Leja e varrimit	2€
6. AKTVENDIMET	
6.1- Aktvendim për Ndërrim të emrit personal dhe mbiemrit	10€

6.2- Aktvendim për Korrigjim të emrit dhe të mbiemrit	5€
6.3- Aktvendim për anulim të regjistrimeve të dyfishta	3€
6.4-Nëse gabimi ka qenë nga Zyrtarët Komunal korrigjimi të bëhet falas	0€
7. VËRTETIMET - KONFIRMIMET	
7.1- Vërtetimi që personi nuk është i regjistruar në RTHL dhe në RTHV	2€
7.2- Vërtetimi mbi mjetet për jetës-mbajtje	5€
7.3- Vërtetimi mbi qëndrimin e përkohshëm në Kosovë (kalim kufiri)	3€
7.4- Konfirmimet e ndryshme	2€
7.5- Vërtetim për lajmërim dhe ç'lajmërim të vendbanimeve	2€
8. KËRKESAT DHE SHKRESAT	
8.1- Kërkesat të ndryshme, parashtrimi i kërkesës së aplikacionit për pjesëmarrje në konkurs	1€
8.2-Kërkesë për qasje në dokumente zyrtare	2€
8.3- Legalizimet – Hiqet si pike komplet, nuk kryhen këto shërbime në komunë	
8.3-Parashtrimi i kërkesës, aplikacionit për pjesëmarrje në konkurs	2€
8.4-Ankesa kundër vendimit në shkallë të parë	2€
8.5- Gjetja dhe pajisja me dokumente nga Arkiva	2€
8.6- Fotokopje të ndryshme për shërbime administrative 1- 20 faqe	0.20€
20 faqe tutje	0.10€
8.7- Kërkesa për lirim nga Shtetësia e Kosovës	10€
8.8. Kërkesa për Fitim të shtetësisë së Kosovës	10€
8.9-Kërkesa për shpenzime të varrimit	2€
8.10- Aplikimi online për shërbimet e gjendjes civile	6 €

5.2 Përjashtim (lirimi) nga pagesa e taksës administrative

Nga pagesa e taksës administrative lirohen grupet e caktuara si dhe në bazë të subjektit të kërkesës. Përgjithësisht nga pagesa e taksës administrative lirohen:

- Organet lokale, regjionale, qeveritare të Republikës së Kosovës si dhe organet e tyre të cilat adresojnë kërkesa zyrtare;
- Rastet sociale;
- Invalidët e luftës, viktimat e dhunës seksuale të luftës si dhe familja e ngushtë e dëshmorëve, viktimave civile dhe të zhdukurve të UÇK-së (sipas Ligjit Nr.04/L-179 dhe Ligjit Nr.04/L-054)
- Peticionet, ankesat dhe propozimet e drejtuara Qeverisë dhe organeve tjera publike;
- Dokumentet dhe veprimet në procedurën e korrigjimit të gabimeve të bëra nga zyrtarët përgjegjës komunal në vendime, dokumente dhe regjistra zyrtarë;
- Dokumentet dhe veprimet në procesin e përgatitjes dhe korrigjimit të listave të zgjedhësve nga KQZ (Komisioni Qendror Zgjedhor) dhe zyrtarët përgjegjës institucional;

Vërejtje: Tarifat paguhen me rastin e paraqitjes së kërkesës. Pa dëshmi mbi pagesën e tarifës nuk mund të dorëzohet dokumenti i kërkuar.

Neni 6

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim

6.1 TAKSA KOMUNALE VJETORE PËR USHTRIM TË VEPRIMTARIVE NË BIZNES

	1. Veprimtari Prodhuese	
1.1	Hidrocentralet	50,000.00€
1.2	Prodhim i energjisë elektrike/alternative/ Panelet Solare/ Energji e Erës	1000.00€
1.3	Gurëthyesit	1000.00€
1.4	Bazë Asfalti	1000.00€
1.5	Betonjerke	600.00€
1.6	Fabrikat për përpunimin e ujit	400.00€
	2. Veprimtarit përpunuese	
2.1	Përpunuesit e prodhimeve të mishit dhe thertoret	50.00€
2.2	Përpunuesit e Qumështit	50.00€
2.3	Kultivimi i frutave	100.00€
2.4	Përpunuesit e elementeve plastikes, aluminit	100.00€
2.5	Metaltpunuesit	70.00€
2.6	Punuesit e gurëve të Varrezave	70.00€
2.7	Ndërmarrjet për menaxhim të mbeturinave	300.00€
	3. Veprimtari Bankiere, e të ngjajshme	
3.1	Bankat	250.00€
3.2	Këmbimoret	150.00€
3.3	Kompanitë e sigurimeve	250.00€
	4. Agjencionet	
4.1	Agjencionet turistike, autobusët	150.00€
4.2	Agjencionet për transfere të parave	100.00€
4.3	Agjencionet Financiare	250.00€
	5. Veprimtarit tregtare	
5.1	Pompat e benzinës	350.00€
5.2	Kompanitë shoqërore dhe publike	200.00€
5.2	Shitore ushqimore dhe të tekstilit deri në 50m2	50 .00€
5.3	Minimarketet prej 51-200m2	150.00€
5.4	Supermarketet mbi 200m2	300.00€
5.5	Shitore e teknikës së bardhë	150.00€
5.6	Shitore e autopjesëve, vajra motor	70.00€
5.7	Shitore e mobileve dhe tepihëve	150.00€
5.8	Shitore e teknikës informative, servisim kompjuterash	80.00€
5.9	Shitore e ngjyrës dhe llaqeve	80.00€
5.10	Ëmbëltoret	50.00€
5.11	Shisha bar	50.00€
5.12	Depot e mallrave ushqimore, pijeve	80.00€
5.13	Depot e materialit ndërtimor	200.00€

5.14	Depot e materialit të drurit	100.00€
5.15	Libraritë	50.00€
5.16	Shitoret optike, kozmetike, bizhuteritë, videoklubet	50.00€
5.17	Barnatoret bujqësore	50.00€
5.18	Barnatoret shëndetësore	150.00€
5.19	Tregtare lëvizëse	30.00€
5.20	Kiosqet	20.00€
5.21	Bufet	50.00€
5.22	Pastrim Kimik	65€
5.23	Kompanit e Pastrimit	80€
	6. Shërbimet hoteliere dhe ushqimore	
6.1	Hotelet	200.00€
6.2	Motelet	150.00€
6.3	Restorantet	100.00€
6.4	Kafiteritë	70.00€
6.5	Mishtore	50.00€
6.6	Bukëpjekësit	80.00€
6.7	Gjellëtore, Qebaptore	100.00€
6.8	Piceritë dhe ushqime të shpejta (fast food)	80.00€
6.9	Kultivuesit e peshkut	100.00€
6.10	Salla të dasmave	500.00€
	7. Veprimtari zejtare	
7.1	Zdrukthëtaritë	80.00€
	8. Veprimtari profesionale	
8.1	Avokat, Noter	150.00€
8.2	Laboratorë, ordinancat mjekësore,	200.00€
8.3	Byrotë projektuese	150.00€
8.4	Gjeodezi dhe Kadastër	150.00€
8.5	Shërbimet financiare dhe kontabilitetit	70.00€
8.6	Shërbimet veterinare	70.00€
8.7	Zyret për përkthim	70.00€
8.8	Kurse profesionale	100.00€
8.9	Ordinanca stomatologjike	350.00€
	9. Veprimtari tjera shërbyese	
9.1	PTK, IPKO.TELKOS, e të ngjashme	350.00€
9.2	KEDS	350.00€
9.3	Ndërmarrjet e taxive dhe auto shkollat	150.00€
9.4	Vend parkingjet	50.00€
9.5	Internetet, lojrat elektronike	50.00€
9.6	Auto-taxi transportues (fugon)	70.00€
1.9	Kontrollat teknike të automjeteve	250.00€
9.7	Auto-taxi pasagjer	50.00€
9.8	Ekskavatorët	200.00€
9.9	Pishinat	80.00€
9.10	Fushat sportive të mbyllura	70.00€

9.11	Fushat sportive të hapura	50.00€
9.12	Fidanishtet	50.00€
9.13	Tv	100.00€
9.14	Radiot	80.00€
9.15	Autolarësit, Gumister	50.00€
9.16	Autoserviset, autoelektricitet, elektroservisimet, automekaniket	150.00€
9.17	Fotografet /video xhiruesit	60.00€
9.18	Frizerët	70.00€
9.19	Sallonet e bukurisë për femra	80.00€
9.20	Moler- gipser	150.00€
9.21	Punuesit e mbishkrimeve të firmave	60.00€
9.22	Elektro ujësjellësit/ Instaluesit e ujit, rrymës	60.00€
9.23	Fitneset	60.00€
9.24	Antenat e rrjeteve	500.00€
9.25	Subjektet që kryejnë vetëm Shërbime ndërtuese (ndërtime të vogla)	90.00€
9.26	Subjektet që kryejnë vetëm Shërbime ndërtuese (ndërtime të larta)	250.00€

Vërejtje: Lirimi nga neni 6 pika 6.1 bëhet si vijon:

- a) Subjektet afariste që regjistrohen për herë të parë, lirohen gjatë dy viteve të para të aktivitetit ndërsa subjektet afariste me pronare gra, lirohen gjatë katër viteve të para të aktivitetit, duke filluar nga hapja e biznesit në vitin 2027.
- b) Të gjitha subjektet afariste të reja dhe ekzistuese që punësojnë mbi 5 punëtor të rinjë nga viti paraprak, lirohen për dy vitet vijuese të aktivitetit (të vërtetohen të punësuarit nga MTI dhe ATK).
- c) Të gjitha organizatat jo qeveritare.
- d) Të gjitha subjektet afariste të cilat pësojnë dëme të konsiderueshme materiale (zjarri, ujë dhe fatkeqesi tjera natyrore), i'u zbritet taksa komunale për 50% nga baza e caktuar e taksës për vitin kalendarik.
- e). Nëse regjistrimi i subjektit afarist bëhet në gjashtëmuorin e parë të vitit kalendarik paguhet ngarkesa për tërë vitin 100%. Nëse regjistrimi i subjektit afarist bëhet në gjashtëmuorin e dytë ngarkesa për atë vit bëhet 50% nga tarifa bazë.
- f) Bizneset të cilat merren me veprimtari bujqësore me karakter prodhues lirohen për 50% nga tarifa bazë.
- g) Bizneset të cilat nderprejnë veprimtarinë e tyre, duhet ta njoftojnë Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim.
- g.a) DEZH njoftohet nga pala nëpërmjet procesverbalit të lëshuar nga Inspektoriati komunal me të cilin konstatohet aktiviteti i veprimtarisë së Biznesit.
- h) Bizneset që operojnë në zonën e II paguajnë 20% më ulët se tarifa bazë
- i) Bizneset në zonat rurale (zona e III) tarifa është 50% më e ulët se tarifa bazë.

Ndarja e zonave e cila vlen vetëm për taksën për ushtrimin e veprimtarisë së bizneseve.

Zona e parë – Përfshin të gjitha objektet që kanë dalje në të dy anët e rrugës magjistrale dhe lokale ku përfshin rrugën “Luan Hradinaj” nga sheshi “Edmond Hoxha” deri te udhëkryqi i rrugës “Tafë Hoxha”, rruga “Fadil Maloku” nga sheshi “Edmond Hoxha” deri te udhëkryqi i rrugës “Januz Neziraj”, rruga “Shelzen Gacaferi” nga sheshi “Edmond Hoxha” deri te udhëkryqi i rrugës “Tafë Hoxha”, rruga “Ukë Lushi” nga udhëkryqi i rrugës “Hasan Prishtina” e deri te udhëkryqi i rrugës “Martiret e Junikut”, rruga “Hasan Prishtina” nga sheshi “Edmond Hoxha” deri te udhëkryqi i rrugës “Haxhi Alia”.

Zona e dytë – Përfshinë të gjitha objektet që kanë dalje në rrugën kryesore “Luan Haradinaj” nga sheshi “Edmond Hoxha” deri te udhëkryqi i rrugës “Ali Bjarkari”, udhëkryqi i rrugës “Januz Neziraj”, rruga “Fadil Maloku”, rruga “Richard Holbruk” deri te udhëkryqi i rrugës “Ismet Gjocaj”, udhëkryqi i rrugës “Tafë Hoxha”, rruga “Shkelzen Gacaferi” deri te udhëkryqi i rrugës “Sali Beqa” deri te udhëkryqi i rrugës “Gzim Pepshi” deri te udhëkryqi i rrugës “UÇK”, rruga “Martiret e Junikut” nga udhëkryqi i rrugës “Ukë Lushi” e deri te udhëkryqi i rrugës “Jah Tofaj”, rruga “Hasan Prishtina” prej udhëkryqit të rrugës “Nora e Kelmendit” e deri te rruga “Troja”. Në këtë zonë përfshihen gjithashtu objektet e banimit që ndodhen në zonat territoriale të njohura si Gacafer, Pepsh, Bajraktari, Berishë, Miroc, Malok, Krasniq, Gaxherr i Ulët, Gaxherr i Epërm dhe Lagjja “Agim Ramadani” e cila dallon nga zona industriale.

Zona e tretë – Përfshinë të gjitha hapësirat të cilat nuk janë përfshirë në zonën e parë dhe të dytë, ato objekte apo lokale që gjinden në rrugët terciare e që i përkasin qytetit të Junikut.

j) Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, me aktvendim do të bëjë ngarkesën për bizneset aktive më së largu deri më 31.03 për vitin kalendarik.

k) Pagesa mund të bëhet me 3 këste (15 prill, 15 korrik dhe 15 nëntor), poashtu mund të lidhet marrëveshje mirëkuptimi një dhe dy vjeçare në mes Komunës së Junikut dhe pronarit të biznesit.

l) Kundër aktvendimit të lëshuar nga ana e Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, subjektet afariste mund të ushtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

m) Bizneset ekzistuese që kanë obligime nuk mund të ç’regjistrohen, pa i shlyer obligimet paraprake.

6.2. SEKTORI I BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Duke u bazuar në udhëzimin administrativ nr.41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, neni 14, paragrafi 14.2, vlejné këto taksa për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore:

- a) klasës 1 – 4 kompenzimi do të jetë 1.00 € për metër katror;
- b) klasës 5 – 6 kompenzimi do të jetë 0.75 € për metër katror;
- c) klasës 7 – 8 kompenzimi do të jetë 0.50 € për metër katror.

6.3 Taksat për shërbimet profesionale për prerje të pyjeve private:

Për zgjedhjen, dëmkimin e trungjeve dhe lëshimin e lejeve për prerjen e trungjeve të klasifikuar si asortiment teknik (industrial) dhe për trungjet e klasifikuar si dru për djegëje, do të zbatohen çmimet si vijon:

- 6.3.1 për zgjedhjen dhe dëmtimin e trungjeve të klasifikuar si dru teknik 3 €/m³;
- 6.3.2 për zgjedhjen dhe shejimin e trungjeve të klasifikuara për dru zjarri, me vëllim më të vogël se 7 m³ (me qëllim të përdorimit për nevoja shtëpiake), 1,50 €/m³;
- 6.3.3 për zgjedhjen, shejimin e trungjeve të klasifikuara për dru zjari, me vëllim më të madh se 7 m³ . - 2 €/m³;

6.4 Lartësia e taksës për shfrytëzimin e kullotave:

Lloji i bagëtisë	NB/ kokë	EUR/ kokë
Gjedhët mbi një vjet	1	1.20
Viçat	0.45	0,54
Delet	0.18	0.22
Qengjat	0.1	0,12
Kuajtë dhe gomarët	1	1,20
Dosat	0,5	0.60
Derrat	0,3	0,36
Rosat	0.014	0,02

Neni 7
Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale

7.1 TARIFAT NË SFERËN E SHËNDETËSISË

Nr. i tarifës, ngarkesave	Shërbimet/aktivitetet, tarifat/ngarkesat	Vlera €
Shërbimet shëndetësore të nivelit parësor		
1	Ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose në QKMF, analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë	1.00
2	Ekzaminimi specialistik në QMF dhe QKMF me udhëzim të mjekut familjes	2.00
3	Ekzaminimi specialistik në QMF QKMF pa udhëzim të mjekut të familjes	5.00
4	Ekzaminimi mjekësor për shtetas të huaj dhe bartës të sigurimeve të huaja	5.00
5	Ekzaminimi në shtëpi përpos në rastet emergjente	6.00
6	Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatore publike	0.30
7	Ultrazëri	2.00
8	Radiografia	2.00
9	EKG	0.50
10	Analizat laboratorike – vetëm hemogrami dhe urina	1.00
11	Analizat laboratorike biokimike	3.00
12	Me përjashtim të rasteve emergjente, qytetarët që kërkojnë shërbime në institucionet e KPSH jashtë zonës së banimit të caktuar nga institucionet përkatëse	5.00
13	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	1.00
14	Audio grami	1.00
15	Shpërlarja e veshit	1.00
16	Dhënia e injeksionit intermuskular në shtëpi, përpos në raste emergjente	1.00
17	Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në raste emergjente	1.00
18	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrim deri në shërim të plagës (vetëm në vizitën e parë)	3.00
19	Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor	1.00
20	Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit ose dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	5.00
21	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktivitetit sportiv etj për një orë	25.00

22	Vizita e parë stomatologjike	1.00
23	Nxjerrja e dhëmbit	1.50
24	Rtg e dhëmbit	1.50
25	Mbushja definitive me amalgam	4.00
26	Mbushja definitive me kompozitë (estetike)	5.00
27	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	5.00
28	Extirpimi vital apo mortal me mbushje definitive	6.00
29	Shërimi i kanalit me mbushje definitive	6.00
30	Hegja e gurzive me ultratingull	3.00
31	Kiretazha e gjepave paradontal (një dhëmb)	1.00

Lirimi nga pagesat: Nga neni 7, pika 7.1, **përveq pikave 16, 17, 18, 19, 20**, lirohen të gjithë veteranët në bazë të Ligjit Nr. 04/L -261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: **Neni 23** e drejta në shërbime shëndetësore falas.

Ekzaminimi mjekësor për shtetas të huaj dhe bartës të sigurimeve të huaja bazohet në udhëzimin administrativ 04/2007 neni 3.10.

1. Veteranët të UÇK-së dhe anëtarët e familjes së ngushtë gëzojnë të drejtën e shërbimit shëndetësor falas sipas dispozitave ligjore në fuqi në spitalet, klinikat dentare dhe qendrat shëndetësore që financohen nga shteti, si dhe përfitojnë falas barnat për sëmundje kronike, sipas kritereve të propozuara nga ministria përkatëse për shëndetësi dhe të miratuara nga Qeveria, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2. Neni 7 pika 12 „ Me përjashtim të rasteve emergjente, qytetarët që kërkojnë shërbime në institucionet e KPSH jashtë zonës së banimit (që nuk janë të Komunës së Junikut) të caktuar nga institucionet përkatëse” është i bazuar në Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Shëndetësisë Nr.03/2024 Bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore të nivelit parësor shtojca 1 pika 7.

3. Taksat e përcaktuara në këtë nen, nuk kanë fuqi juridike nëse me legjislacionin primar të aplikueshëm do të ndryshohen.

Neni 8.

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Inspeksion

8.1 TAKSA DHE GJOBA NGA SHËRBIMET PUBLIKE KOMUNALE DHE INSPEKTIMI

1	Taksat për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirave publike, për kryerjen e veprimtarisë së tyre, subjektet afariste të regjistruara	
1.1	Aparatet për akullore dhe ruajtjen e tyre të vendosura jashtë lokaleve -Tarifë ditore	0.7€/m ²
1.2	Auto-dyqani lëvizës(dyqani mobil) - Tarifë ditore	0.7€/m ²
1.3	Dhënia e tokës me qira për kampingje, për vendosjen e lojërave të ndryshme - Tarifë ditore	0.20€/m ²
1.4	Ekspozimi i mallrave para lokaleve afariste, në sipërfaqen e hapur publike, në të cilat nuk pengohet lëvizja e lirë e këmbësorëve - Tarifë mujore	2.00€/m ²
1.5	Vendosja e tavolinave para lokaleve hoteliere afariste në sipërfaqen e hapur publike, në të cilat nuk pengohet lëvizja e lirë e këmbësorëve - Tarifë mujore	2.5€/ m ²
1.6	Vendosja e tendave lëvizëse promovuese në sipërfaqet e lira publike - tarifa ditore	5.0 €/ m ²
1.7	Vendosja e tendave lëvizëse në sipërfaqet e lira publike jashtë zonave të banimit - Tarifa ditore	0.50€/m ²
1.8	Tezgat e vendosura para dyqanit - Tarifa ditore	0.7€/m ²
1.9	Aparatet për pomfrit dhe të ngjashme, të vendosura jashtë lokalit - Tarifë ditore	0.7€/m ²
2	Taksa për dhënie me qira të hapësirës publike për shfrytëzimin komercial paguhet	
2.1	Vendosja e shpalljeve dhe publikimeve të përkohshme, në muret dhe objektet tjera - Taksë vjetore	25 € / m ²
2.3	Vendosja e panove reklamuese me ndriçim-Bilboard dhe Citylight në m2 - Taksë vjetore	60€/ m ²
2.4	Vendosja e panove reklamuese jashtë qytetit	20€/ m ²
2.5	Leje për vendosjen e transmetuesve (antenave), me frekuenca të ndryshme për nevoja të telefonisë mobile, fikse, televizionit dhe të ngjashme, paguhet tarifa vjetore sipas zonave (zonat e ndara në Rregulloren e Tatimit në Pronë): a) Zona I dhe Zona I A.....600 €/vit b)Zona II.....450€/vit c) Zona III.....400€/vit d) Zona IV.....300€/vit Vendosja e antenave në Pronë private paguan 50 % të shumës sipas këtyre zonave	
2.6	Vendosja e objekteve MDF – kutia(trafo)në sipërfaqe publike - Taksë vjetore	150€/ m ²
2.7	Leja e punës për auto taxi	50 €
2.8	Vazhdimi i lejes për auto-taxi - Taksë vjetore	15 €
2.9	Leja e punës për autobus	70 €
2.10	Vazhdimi i Lejës se punës për autobus – Taksë vjetore	40 €
3	Leje për ndërhyrje në Infrastrukturë dhe hapësirë tjetër publike (personi fizik)	
3.1	Leje për prerjen e asfaltit në rrugë dhe trotuare për 1m ²	50 €
3.2	Leja për shpuarjen e asfaltit në rrugë dhe trotuare për 1m gjatësi	5 €
3.3	Leja për prerjen e rrugëve dhe trotuareve të rregulluara me kubza betoni, dhe hapësirave të gjelbërta për 1m ²	30€
3.4	Leja për prerjen e rrugëve dhe trotuareve te pa kategorizuara(me zhavorr) për 1m ²	5€

vërejtje	Personat fizik që ndërhyrjnë në infrastrukturë dhe hapësirë publike, pasi ta përfundojnë punën, janë të obliguar ta përgatisin vendin për asfaltim, ndërsa komuna e kryen asfaltimin e asaj pjese të dëmtuar.	
4	Leje për ndërhyrje në Infrastrukturë dhe hapësirë tjetër publike për Ndërmarrjet Publike të cilat ofrojnë shërbime publike për qytetarë dhe Ndërmarrjet private (Persona Juridik)	
4.1	Leje për prerjen e asfaltit në rrugë dhe trotuare për 1m ²	100 €
4.2	Leja për prerjen e rrugëve dhe trotuareve të rregulluara me kubëza betoni, dhe hapësirave të gjelberta për 1m ²	60 €
4.3	Leja për prerjen e rrugëve dhe trotuareve të pa kategorizuara(me zhavorr) për 1m ²	10€
4.4	Leja për vendosjen e infrastrukturës nëntokësore(kabllove, gypave të ndryshëm) 1 m ¹	2€
4.5	Shtrirja e rrjetit kabllor (ajror) në hapësirat publike tarifa për 1 njësi x 1m ¹	1€
Vërejtje	Personat juridik që ndërhyrjnë në infrastrukturë dhe hapësirë publike, pasi ta përfundojnë punën, janë të obliguar ta përgatisin vendin për asfaltim, ndërsa komuna e kryen asfaltimin e asaj pjese të dëmtuar.	
5	Ngarkesat për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike në m² sipas zonave (zonat e caktuara në Rregulloren e Tatimit në Pronën e Paluajtshme të Komunës Junik)	
5.1	Leja për Vendosjen e qoshqeve (kiosqeve)dhe objekteve të tjera prej montazhi, në të cilat kryhet veprimtaria (tregti, hoteleri) tarifa mujore në m² sipas zonave	
5.1.1	Zona e I-rë dhe Zona I A	4€/ m ²
5.1.2	Zona e II-të	3€/ m ²
5.1.3	Zona e III-të dhe Zona IV	2€/ m ²
6	Leje për vendosjen e tendave të hapura dhe lëvizëse për shitjen e librave jo shkollore, caktohet tarifa mujore sipas zonave	
6.1	Zona e I-rë dhe Zona e I A	4€/ m ²
6.2	Zona e II-të	3€/ m ²
6.3	Zona e III-të dhe Zona e IV	2€/ m ²
7	Leja për Vendosjen e objekteve statike në hapësirën publike (gjenerator, bankomate dhe objekte tjera për çfarëdo aktiviteti afarist) tarifa vjetore për 1m²	
7.1	Zona e I-rë dhe Zona I A	40€/ m ²
7.2	Zona e II-të	30€/ m ²
7.3	Zona e III-të dhe Zona IV	20€/ m ²
8	Vendosja e tendave të hapura dhe lëvizëse për promovimin, reklamimin apo qfare do aktiviteti afarist- tarifa ditore në m²	
8.1	Zona e I-rë dhe Zona e I A	3€/ m ²
8.2	Zona e II-të	2€/ m ²
8.3	Zona e III-të dhe Zona IV	1€/ m ²
9	Lejet për shfrytëzimin e hapësirave publike-tarifat mujore për m²	
9.1	Leja për vendosjen e materialit ndërtimor në hapësira publike për 1 m ²	1.00€
9.2	Leje për ndaljen(ngarkim-shkarkim) të mallrave në trotuar, maksimumi 2 orë (tarif mujore)	5 €
9.3	Leje për bllokimin e rrugës-shiritit rrugor-trotuarit për 1 m ²	10€
9.4	Leje për bartjen e zhavorrit (rërës) për m ³	0.20 €
10	Leje për shfrytëzimin e hapësirave publike që shfrytëzohen për vendosjen e lojërave të ndryshme, argëtuese , cirke etj. Tarifa ditore	

10.1	shfrytëzimi për 1 deri në 5 ditë	
10.1.1	Zona e I-rë, I A dhe e II-të për 1m ²	12 cent
10.1.2	Zona e III-të dhe IV-tër për 1m ²	10 cent
10.2	shfrytëzimi për 5 deri në 10 ditë	
10.2.1	Zona e I-rë, I A dhe e II-të për 1m ²	10 cent
10.2.2	Zona e III-të dhe IV-tër për 1m ²	8 cent
10.3	shfrytëzimi deri në 30 ditë	
10.3.1	Zona e I-rë, I A dhe e II-të për 1m ²	7 cent
10.3.2	Zona e III-të dhe e IV-tër për 1m ²	4 cent

11	Tarifat për leje qarkullimin e automjeteve të rënda mbi 3.5t motorike në rrugët ku është e ndaluar qarkullimi i automjeteve në fjalë:	
11.1	Për 1 deri në 3 ditë	15€
11.2	Leje 1 deri 15 ditë	30€
11.3	Leje mujore	100€
12	Tarifat për shërbime Inspektuese	
12.1	Kërkesë për kontroll inspektues në qytet për persona fizik	10€
12.2	Kërkesë për kontroll inspektues në qytet për subjektet afariste	20€
12.3	Kërkesë për pëlqime pune	15€
12.4	Kërkesë për asgjësim malli	15€
12.5	Kërkesë për dalje ne teren për PTK, KEDS, jashtë qyteti	150€
12.6	Kërkesë për dalje ne teren për PTK, KEDS, brenda qyteti	100€
12.7	Tarifa për dhënien e pëlqimit për mbrojtje kundër zjarrit	5€
12.8	Inspeksion-tarifat do te aplikohen ne mbështetje te Ligjit mbi ndërtimin Nr.04/L110 dhe udhëzimit Administrativ 17/2015.	
13	Për Inspektime jashtëzakonshëm me kërkesën e palës nga ana e inspektoreve caktohen këto tarifa	
13.1	Inspektori i Tregut	50€
13.2	Inspektori i Bujqësisë	50€
13.3	Vërtetim për lejim të shfrytëzimit të rrugëve me peshë më të rënd se sa lejohet	50€

14	Për lejen e ushtrimit të Veprimtarisë afariste, përcaktohet lartësia e shpenzimeve të bëra në procedurën e kryerjes së mbikqyrjes Inspektuese (komisioni komunal) sipas kërkesës së palës me qëllim të përcaktimit të plotësimit të kushteve minimale tekniko-sanitare-higjenike. Parashtruesi i kërkesës është i obliguar që krahas kërkesës në emër të shpenzimeve të procedurës së mbikqyrjes inspektuese të paguaj shumën e caktuar në të holla sipas objektit dhe atë:	
	Emërtimi	Vlera €
14.1	Objekte industriale prodhuese	200€
14.2	Shitore me shumicë-depo	100€
14.3	Shitja e derivateve të naftës	80€
14.4	Hotelet dhe motelet me restorante	150€
14.5	Restorantet	100€
14.6	Klinikat dhe ordinancat mjekësore	80€
14.7	Barnatore humane	80€
14.8	Laboratorët biokimik	50€
14.9	Barnaret bujqësore	80€
14.10	Vetëshërbim	70€
14.11	Gjellëtoret, ëmbëltoret, kafiteritë	50€
14.12	Dyqanet e pavarura tregtare	30€
14.13	Dyqanet e pavarura zejtare	20€
14.14	Serviset e TV, radio aparatet, paisjet e amvisërisë etj.	20€
14.15	Zyrat për përkthim në gjuhët e huaja	30€
14.16	Avokatura	50€
14.17	Kioskat	10€
14.18	Agjensit turistike dhe te sigurimit	50€
14.19	Zyrat administrative –selia e biznesit	30€
14.20	Auto parkingjet	20€
14.21	Pishinat	20€
14.22	Hekurishtat	30€
14.23	Autolarjet	20€
14.24	Vullkanizer(Gomister)	30€
14.25	Bankat	150€
14.26	PTK	200€
14.27	Këmbimore	50€
14.28	Fushat Sportive	30€
14.29	Objektet për përpunimin e qumështit	30€
14.30	Fermat	30€
14.31	Prodhesit individual te pijeve	80€

14.32	Qendrat tregtare	200€
14.33	Supermarketet,Hipermarketet	100€
14.34	Automekaniket	30€
14.35	Auto Elektricist	30€
14.36	Seperacionet	100€
14.37	Prodhimi i gypave, kubëzave etj. Prej betoni	100€
14.38	Prodhimi i gypave ,dyerve,dritareve etj.prej plastike	100€
14.39	Depot e materialit ndërtimor	100€
14.40	Teknikë të bardhë	50€
14.41	Pjesë të automjeteve	50€
14.42	Internet kafet	50€
14.43	Mishtoret	100€
14.44	Qebaptore	80€
14.45	Burektore	50€
14.46	Embëltore	50€
14.47	Bukëpjekësit	50€
14.48	Kafiteritë	75€
14.49	Frizer per meshkuj	50€
14.50	Frizer për femra	50€
14.51	Auto shkollat	100€
14.52	Qerdhet e fëmijëve	100€
14.53	Mbajtja e kurseve të ndryshme profesionale	100€
14.54	Fotografistë	50€
14.55	Sallonet e darsmave	100€
14.56	Fitnese	50€
14.57	Depo e ndërmarrjeve Industriale	300€
14.58	Depo e ndërmarrjeve Prodhuese	200€
14.59	Depo e ndërmarrjeve Ndërtimore	100€
14.60	Depo e ndërmarrjeve tjera	80 €
14.61	Kontrolla Teknike e Automjeteve	100€
14.62	Ndërtimi i rrugëve (ndërtim i ulët, kubëza betoni etj)	100€
14.63	Agjensionet financiare	50€
14.64	Të tjera	50 €

15. Gjobat nga Inspekcioni		€
15.1	Mos përfshierja e bizneseve ne shërbimin e mbeturinave.	100.00
15.2	Mos përfshierja e ekonomive familjare ne shërbimin të mbeturinave.	50.00
16. Për ekspozim te mallrave ushqimore dhe pijeve (të produkteve dhe nën produkteve ushqimore dhe industriale në ambientet klimatike dhe mikroklimatike qe janë në kundërshtim me kushtet e ruajtjes dhe shitjes (jo adekuate higjienike) ne treg, apo në kundërshtim me kushtet e dhëna nga deklaracioni i prodhuesit.		
16.1	Për persona juridik.	100.00
16.2	Personi fizik.	50.00

17. Konfiskimi i të gjitha mallrave (artikujve) me afat të skaduar ushqimore, pijeve dhe produkteve tjera si: medicinave, kozmetike, etj.		
17.1	Lëshimi i vërtetimit për konfiskim, izolim apo dhe shkatërrim malli ushqimor dhe te pijeve në peshë prej; 5kg 100 kg.	30.00
17.2	Në peshë prej;100 kg e më shumë.	70.00
17.3	Lëshimi i vërtetimit, për izolim, konfiskim dhe shkatërrim malli ushqimorë dhe produkte tjera farmaceutike, kozmetike në varësi nga sasia e mallit dhe vlerës së regjistruar duke pasur parasysh sasinë e mallit prej 5 kg deri në 100 kg.	50.00
17.4	Lëshimi i vërtetimit, për izolim, konfiskim dhe shkatërrim malli ushqimorë dhe produkte tjera farmaceutike, kozmetike në varësi nga sasia e mallit dhe vlerës së regjistruar duke pasur parasysh sasinë e mallit mbi 100 kg.	100
17.5	Shqiptimi i gjobës ndaj personit përgjegjës të personit juridik për mallra me afat të skaduar	50
17.6	Shqiptimi i gjobës ndaj personit juridik për mallra me afat të skaduar	100
18. Marrja e mostrës dhe hulumtimi i artikujve ushqimor dhe pijeve		
18.1	Nga ana e inspektorit të tregut në bazë të kushteve të dyshimta të artikullit apo pijeve ushqimore në subjektin afarist tregtar ushqimor shërbyes etj marrja e kësaj mostre në atë subjekt do të bien barrë shpenzimi i një mostre në vlerë.	30.00
19. Në rast të helmimit me artikuj ushqimor, intoksikacionit dhe toksik infeksionit me ushqim të dyshuar në subjektet e ofrimit të shërbimeve me artikuj ushqimor dhe pijeve etj dhe vërtetimi mjekësor i gjendjes së personit të helmuar do të pasojë masa të gjobës.		
19.1	Shpenzimet e mostrimit dhe shërbimet e tjera do t'i bart subjekti në fjalë.	100.00
19.2	Në rast të rezultateve pozitive nga institucionet shëndetësore mbi infeksionin apo helmimin e klientit nga subjekti afarist tregtar apo shërbyes me artikuj ushqimor pije etj masa e gjobës do të jetë.	300.00
19.3	Ankesa e qytetarit drejtuar inspeksionit sanitar për produktin ushqimor jo higjienik-shëndetësor, në rast të verifikimit nga ana e inspektorit sanitar dhe vërtetimit në subjektin afarist të atij artikulli ushqimor gjoba do të jetë	50.00

20	Kyçja pa leje në rrjetin e ujësjellësit	
20.1	Personi Fizik	50€
20.2	Personi juridik tarifa vlen për një banesore-afariste	100€
21	Derdhja e ujërave të zeza në hapësira publike	
21.1	Personi Fizik	50€
21.2	Personi juridik tarifa vlen për një banesore-afariste	100€
22	Ndërhjyra pa leje në infrastrukturë publike	
22.1	Personi Fizik	100€
22.2	Personi juridik	150€
23	Dëmtimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë kryerjes së punëve të ndryshme ndërtimore	
23.1	Dëmtimi i asfaltit për 1 m ²	30€
23.2	Dëmtimi i gurëve(kubëza ose pllaka) për 1 m ²	20€
23.3	Dëmtimi i skajoreve 1 m ²	20€
23.4	Dëmtimi i rrigollave 1 m ²	20€
24	Hedhja e mbeturinave Inerte në hapësira publike	
24.1	Personi Fizik	70€
24.2	Personi juridik	100€
25	Hedhja e mbeturinave organike në hapësira publike	
25.1	Personi Fizik	20€
25.2	Personi juridik	100€
26	Gërvishtja, prerja, lakimi, ndotja ose dëmtimi në çfarëdo forme i objekteve me interes të përgjithshëm siç janë : ndriçimi publik, shenja e komunikacionit, hapërisat publike	
26.1	Personi Fizik	50€
26.2	Personi juridik	100€
26.3	Dëmtimi i shtyllës ndriçuese(komplet)njëshe	300€
26.4	Dëmtimi i shtyllës ndriçuese(komplet)dyshe	500€
26.5	Dëmtimi i bimëve dekorative nëpër parqe	30€
26.6	Dëmtimi i ulëseve dhe pjesëve përcjellëse të parqeve (ndotja, thyerja dhe dëmtimet tjera).	30€
26.7	Kalimi (shkelja me këmbë nëpër sipërfaqet e gjelbruara të parqeve dhe hapësirave tjera të ndaluara)	20€
26.8	Kalimi (shkelja me mjet motorik nëpër sipërfaqet e gjelbruara të parqeve dhe hapësirave tjera të ndaluara)	100€
26.9	Ndotja e ambientit nga rrjedhja apo derdhja e betonit nga komioni me cisternë - personi juridik apo biznesi	500€
26.10	Ndotja e ambientit nga rënia e rërës apo zhavorit nga mjeti motorik që bënë transportin i cili nuk ka vendosur mbulesen adekuate për transport	100€

26.11	Ndotja e rrugëve publike përmes qarkullimitme mjet motorik me goma të papastruara nga balta, plehu apo të ngjashme për persona fizik	50€
26.12	Ndotja e rrugëve publike përmes qarkullimitme mjet motorik me goma të papastruara nga balta, plehu apo të ngjashme për persona juridik	100€
27	Shfrytëzimi pa leje i trotuareve dhe hapësirave publike	
27.1	Vendosja pa leje e reklamave, panove dhe objekteve tjera reklamuese për 1 m ²	70€
28	Vendosja pa leje e objekteve të vogla deri në 1m² (tavolina, gjenerator, objekte reklamuese etj.)	
28.1	Personi fizik	30€
28.2	Personi Juridik	100€
28.3	Objektet më të mëdha lëvizëse mbi 1 m ² (gjenerator, kioskë, bankomat, automjeteve për reklamim etj.	100€
29	Mospastrimi i trotuareve pranë lokaleve afariste dhe objekteve të banimit	
29.1	Mos pastrimi i hapësirave me bore dhe akull para objekteve të banimit në trotuare për persona fizik	50€
29.2	Mos pastrimi i hapësirave me bore dhe akull para objekteve të banimit në trotuare për persona juridik	100€
29.3	Mos pastrimi i hapësirave (largimi i mbeturinave) para objekteve të banimit në trotuare për persona fizik	50€
29.4	Mos pastrimi i hapësirave (largimi i mbeturinave) para objekteve të banimit në trotuare për persona juridik	100€
30	Hedhja e mbeturinave të amvisërisë në hapësirë publike - private	
30.1	Personi fizik	50€
30.2	Subjektet afariste – personat juridik	100€
31	Mosrespektimi i ndarjes së mbeturinave në burim	
31.1	Personi fizik	50€
31.2	Personi juridik	100€

Në rastin e mos përmbushjes së cilës do tarifë të parapara sipas nenit 8 të kësaj rregulloreje do të merren masat si në vijim:

1. Personit juridik do t'i rritet gjoba e caktuar,100%
2. Personit fizik do t'i rritet gjoba e caktuar,50%

Ushtrimi i veprimtarisë në biznes në mënyrë të jashtëligjshme brenda territorit të Komunës së Junikut, do të gjohet me dyfishin e shumës së paraparë të taksës për ushtrim të veprimtarisë në biznes sipas Nenit 6 dhe 8 të kësaj Rregulloreje.

Neni 9

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis

9.1 TAKSAT PËR SHËRBIMET E GJEODEZISË DHE KADASTRIT

9.1.1 Lista e produkteve dhe shërbimeve që ofrohen Zyra Kadastrale Komunale dhe tarifat e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr.04/2024 për produktet, shërbimet kadastrale, gjeodezike dhe regjistrim të pronave

Tarifat për produktet e përgatitura digjitale (jpg) sipas shkallës së zvogëlimit

Nr.	Përshkrimi	Çmimi/€
1	Printimi A4 bardhë -zi	2
2	Printimi A4- kolor	3

Tarifat për produktet: Hartat dhe ortofotot digjitale

Nr.	Përshkrimi	Çmimi/€
1	Ndërtesat vektor - Shtëpi banimi	2
2	Objektet banesore - kolektive	5

Tarifat për shërbime kadastrale dhe gjeodezike

Nr.	Përshkrimi	Çmimi/€
1	Informata per nesi kadastrale	2
2	Informata per zone kadastrale - statistike	20
3	Infomata kadastrale për komune - statistikë	30

Tarifat për hartat dhe Ortofotot Digjitale vetëm për Institucione Publike

Nr.	Përshkrimi	Çmimi/€
1	Harta kadastrale digjitale	5
2	Parcela - digjitale - shanefile. DËG - file	5

SHTOJCA 2 TARIFAT PËR SHËRBIMET PËR REGJISTRIMIN E TË DREJTAVE TË PRONËS SË PALUAJTSHME

Tarifa për regjistrimin e të drejtave në regjistrin e të dhënave kadastrale

Nr.	Përshkrimi	Çmimi/€
1	Regjistrimi i të drejtave në bazë të Kontratës së shitbleries	30
2	Regjistrimi i të drejtave në bazë të Kontratës së dhurimit	30
3	Regjistrimi i të drejtave në bazë të Kontratës së mbi mbajtje e përjetshme	30
4	Regjistrimi i të drejtave në bazë të Aktvendimit mbi shqyrtimin e trashëgimisë apo Testamentit	30
5	Regjistrimi i të drejtave në bazë të Vendimit të organit Administrativ, Gjyqësor dhe cdo dokumenti juridik që parashihet fitimi i pronësisë	30
6	Regjistrimi i të drejtave në bazë të aktit juridik për krijimin e bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët	30
7	Regjistrimi i ndarjes nga bashkëpronësia apo pronësia e përbashkët në bazë të aktit juridik	30
8	Regjistrimi i shkëputjes së bashkësisë familjare, në bazë të aktit juridik	30
9	Lirohen nga tarifa rastet kur kemi të bëjmë me ri regjistrim të pronave të paluajtshme në kadastër	
10	Regjistrimi i të drejtave në bazë të ndërrimit-këmbimit të pronës së paluajtshme në bazë të aktit juridik	30
11	Regjistrimi i qirasë nga personi fizik apo juridik në bazë të aktit juridik	30
12	Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit - Qira mbajtjes, për pronat e privatizuara nga ish Ndermarrjet Shoqërore me kohëzgjatje prej nëntëdhjetë e nëntë vite (99)	30
13	Lirohet nga tarifa regjistrimi i së drejtës së shfrytëzimit -qira mbajtjes në emër të Qeverisë apo Komunës	
14	Regjistrimi i bartjes-transferimit të paluajtshmërive nga personi fizik te personi juridik në të cilin bartësi ka pronësi dhe anasielltas.	30
15	Lirohet nga tarifa për regjistrimin e ndarjes nga bashkëpronësia kur në zonat urbane ndarja bëhet me qëllim të ndërtimit dhe krijimit të gjendjes juridike dhe kadastrale sipas planit urbanistik, para se të merret leja e ndërtimit dhe ndaria bëhet me pëlqimin e fqinjëve të asai piese të parcelës.	

Tarifat për regjistrimin e njësive kadastrale

Nr.	Përshkrimi	Çmimi/€
1	Tarifa për regjistrimin e njësive të re kadastrale	10
2	Lirohet nga tarifa për regjistrimin e pronësisë së përbashkët të ndërtesave kolektive në bashkëpronësi	
3	Lirohet nga tarifa për regjistrimin e hapësirave të përbashkëta si njësi të veçanta	
4	Pararegjistrimi i të drejtës së ndërtimit sipas lejës ndërtimore si shënim në parcelë bëhet pa pagesë.	
5	Pararegjistrimi i ndërtesës dhe pjesës së ndërtesës	5

Tarifat për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e Hipotekavës

Nr.	Përshkrimi	Çmimi/€
1	Regjistrimi i hipotekës	30
2	Modifikimi i hipotekës	10
3	Lirohet nga tarifa fshirja e hipotekës nga Realiistri	
4	Hipoteka e cila regjistrohet në dy apo më shumë ZKK. tarifa përpjesëtohet në mënyrë të barabartë nga pika 1	

Tarifa për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e servitutit

Nr.	Përshkrimi	Çmimi/€
1	Regjistrimi i të drejtës së servitutit për secilën parcel dominante apo person	30
2	Modifikimi i servitutit	10
3	Fshirja e servitutit nga Regjistri	30
4	Servituti i cili regjistrohet në dy apo më shumë ZKK, tarifa përpjesëtohet në mënyrë të barabartë nga pika 1	

Tarifa për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e barrëve dhe ngarkesave tjera

Nr.	Përshkrimi	Çmimi/€
1	Lirohet nga tarifa regjistrimi i barrës	
2	Lirohet nga tarifa regjistrimi i masës së sigurisë (masës së përkohshme) apo modifikimin e saj	
3	Regjistrimi i vërejtjes sipas Ligji Nr.08/L-237 për kadastrën të pronës së paluaitshme	10
4	Regjistrimi i ndalesës nga Përmbartuesi Privat apo Gjykata në procedurë përmbartimore për akt juridik	30
5	Regjistrimi i vërejtjes në bazë të Kontratës mbi mbajtjen e përjetshme	10
6	Lirohet nga tarifa modifikimi i barrës apo ngarkesës tjetër	
7	Lirohet nga tarifa fshirja e barrës apo ngarkesës tjetër	
8	Tarifa për regjistrimin e të drejtave të cilat nuk janë përfshirë me dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ	30
9	Lirohet nga tarifa Shërbimi I institucioneve publike, lokale dhe subjekteve me autorizime publike në të dhëna kadastrale	

Tarifa për korrigjimin e të dhënave kadastrale

Nr.	Përshkrimi	Çmimi/€
1	Korrigjimi i të dhënave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar gabim si pasojë e dokumentacionit të dorëzuar nga palët	20
2	Lirohet nga tarifa korrigjimi i të dhënave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar si pasojë e gabimit të ZKK apo AKK, dhe të gjitha gabimet e konstatuara nga sistemet e mëparshme. Si dhe korrigjimi nga regjistrat e vjetër kadastral apo dokumentet tjerë relevante	
3	Lirohet nga tarifa korrigjimi i numërit identifikues “KCID” në numër personal të pronarëve. ZKK është e obliguar që të bëjë korrigjimin e numrit identifikues “KCID” sipas detyrës zyrtare	

Tarifa për informatat nga Sistemi i Informacioneve Kadastrale të Tokave të Kosovës

Nr.	Përshkrimi	Çmimi/€
1	Vërtetim që personi fizik ose iuridik nuk posedon prona	1
2	Certifikata e pronësisë (deri në dhjetë faqe shënime të shtypura)	2
3	Certifikata e pronësisë (mbi dhjetë faqe shënime të shtypura)	10
4	Kopja e planit	2
5	Kopje në formatin A3 me ortofoto (bardhë e zi)	5
6	Kopje në formatin A3 me ortofoto (Kolor)	5
7	Historiati për njësi kadastrale - deri në pesë (5) njësi 50 Euro, mbi pesë (5) njësi 70 Euro	

Tarifat për bazën gjeodezike

Nr.	Përshkrimi	Çmimi/€
1	Pika referente - Rendi i III-të	2
2	Pikat triaonometrike	2
3	Pikat poliaonale	2
4	Pikat lidhëse	2
5	Pikat e kufiive të njësisve kadastrale Y. X	1

Tarifat për të dhënat në formë digjitale për parcela

Nr.	Përshkrimi	Çmimi/€
1	Parcela në format digjital (shpfile. dëg. grnl. iii) deri në 1 ha,	10
2	Parcela në format digjital (shpfile. dëg. gml. iii) mbi 1.01 ha deri 2 ha	20
3	Parcela në format digjital (shpfile. dëg. gml. iii) mbi 2.01 ha deri 5 ha	30
4	Parcela në format digjitale (shpfile. dëg. gml. iii) mbi 5 ha	40
5	Ndërtesa -shtëpi banimi (shpfile, dëg. gml, iii)	2
6	Ndërtesa - banim kolektiv (shpfile. dëg. gml. iii)	5
7	Pjesa e ndërtesës në format digjital (shpfile. dëg. gml, iii)	5
8	CD-kompakt disku	0.50

Lirimi nga pagesa e tarifës bazuar në Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr.04/2024, neni 8.

1. Të gjithë studentët kosovar dhe ata që vijnë nga vendet tjera me qëllime të përgatitjes së seminareve dhe punimeve të diplomës, me vërtetimin e lëshuar nga fakulteti përkatës, lirohen nga pagesa e produkteve të kërkuara deri në shumën prej njëqind euro (100 €) brenda një viti akademik.
2. Për kërkesat e studentëve të studimeve master dhe doktorantë, kur volumi i shënimeve tejkalon shumën nga paragrafi 1 i këtij neni, vendosë Drejtori Ekzekutiv i AKK-së.
3. Lirohen nga pagesa e tarifave për regjistrim, nga të gjitha pikat brenda shtojcës numër 2, Tarifat për Shërbimet për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së paluajtshme grupet e mëposhtme:
 - 3.1 Nënata vetushqyese;
 - 3.2. Personat me asistencë sociale, më konkretisht gratë në asistencë sociale;
 - 3.3 Personat me aftësi të kufizuara;
 - 3.4 Viktimat e dhunës në familje;
 - 3.5 Të mbijetuarat/it e dhunës seksuale gjatë luftës.
4. Personat nga paragrafi 3 duhet të prezantojnë dëshmi nga organizata ku bëjnë pjesë.
5. Lirohet nga tarifa regjistrimi i pronësisë për ndërtesat individuale të ndërtuara nga komuna apo qeveria përmes programeve për ndihmë humanitare.
6. Lirohen nga pagesa e tarifave të Shtojcës 2, Tarifat për Shërbimet për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, të gjithë personat për të cilët është paraparë lirimi nga tarifatat sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

9.2 TARIFAT DHE NGARKESAT PËR NDËRTIM DHE URBANIZËM

	1. Lejet e ndërtimit (sipas UA 04/2017 për kategorizimin e ndërtimeve)	
1.1	Objektet e banimit për kategorinë e parë:	1.49 €
1.1a	Për legalizimin e objekteve individuale të banimit	
	Sipas ligjit të legalizimit	/
1.2	Objektet kolektive të banimit, objektet biznesit për m ² (kat. e II-të)	2.68 €
1.2a	Për legalizimin e objekteve (lokaleve) afariste	
	Sipas ligjit të legalizimit	/
1.3	Mbindërtimi dhe shëndërimi i hapësirave të përbashkëta në banim për m ²	2.68/€
1.4	Ndërtimi I bodrumit- sipas vlerës së taksës bazë	50%
1.5	Ballkonet, terasat dhe loxhat- sipas vlerës së taksës bazë	50%
1.6	Hapësirat e mbuluara të shfrytëzuara- sipas vlerës së taksës bazë	50%
1.7	Tarifa për Rritja e densitetit të infrastrukturës vetëm për njësitë e reja të banimi m ²	2.86 €

9.2 a. Tarifat dhe ngarkesat tjera në lidhje me lejet e ndërtimit do të inkasohen sipas tarifave të përcaktuara nga dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara nga institucionet qendrore.

	2. Për lëshimin e vërtetimit në caktimin e vlerës së objektit:	
2.1	Për objektet deri më 100m ²	50.00
2.2	Për objektet prej 101–500m ²	100.00
2.3	Për objektet prej 501–1000m ²	150.00
2.4	Për objektet prej 1001–2000m ²	200.00
2.5	Për objektet më të mëdha, për çdo 1000m ² , tarifa rritet për	50.00
*Vlerësimi bëhet nga Komisioni për vlerësime të pasurisë i formuar nga BD;		
	3.Për daljen në teren sipas kërkesave	
		10.00
Verejtje: Këtu përjashtohen rastet e daljes në terren gjatë shqyrtimit të kërkesave për leje ndërtimi dhe për leje shfrytëzimi.		
3.1	Për lëshimin e ekstrakteve nga planet urbanistike	20.00
3.2	Për lëshimin e dëshmisë për interesimin apo jo të KK-së për blerjen pasurisë së patundshme në territorin e tij-saj	10.00
3.3	Për dhënien e Pëlqimeve të ndryshme	20.00
3.4	Lëshimi i vërtetimeve të ndryshme	10.00
3.5	Pagesa për lejerrëni (kat e I-rë dhe e II-të)	0.92€
3.6	Pagesa për lëshimin e kushteve ndërtimore	20.00
3.7	Leja Mjedisore Komunale – për projektet në vlerë investive deri në 25000 €	50€
3.8	Leja Mjedisore Komunale për projektet në vlerë investive mbi 25.000€	0.2% vlerës së projektit
3.9	Lëshimi i Certifikatës së përdorimit	20€

4. Matja e ndërtesave		
4.1	Matja për një ndërtesë individuale për 1m ²	0.50
4.2	Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcele	0.25
4.3	Ndërtesë banimi kolektivë për 1m ²	2.00
4.4	Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë	1.00
4.5	Ndërtesa afariste për 1m ²	4.00
4.6	Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për 1m ²	2.00
4.7	Ndërtesa banesore-afariste për 1m ²	3.00
4.8	Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për 1m ²	1.50
4.9	Ndërtesë e administrates qeveritare dhe publike për 1m ²	1.50
4.10	Për çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për 1m ²	0.50
4.11	Objektet për sportë dhe rekreacion (stadium, halla sportive etj.)	2.00
4.12	Objektet kulturore dhe fetare për 1m ²	1.00
4.13	Për çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për 1 m ²	0.50
5. Matjet e pjesëve të ndërtesave		
5.1	Hapsirat banesore dhe përpilimi i skicave për 1m ²	0.25
5.2	Hapsirat afariste dhe përpilimi i skicës për 1m ²	0.35
5.3	Ndarja e hapësirave banesore dhe përpilimi i skicës për 1m ²	0.45
5.4	Ndarja e hapësirës afariste dhe përpilimi i skicës për 1m ²	0.50
6. Matjet e përvojave		
6.1	Përvoja nëntokësore për 1m ²	1.00
6.2	Përvoja mbitokësore për 1m ²	0.50
7. Tokat me shfrytëzim të përkohshëm me ndërtim të objekteve për qëllim të bizneseve prodhuese caktohet:		
7.1	Tarifa vjetore	0.20 €/m ²
8. Ngarkesat për pronën për shfrytëzim afatshkurtër		
8.1	Objektet (zyra) në pronë komunale- tarifa mujore	4.00 €/m ²
8.2	Lokalet (afariste) në pronë të komunës- tarifa mujore	4.00 €/m ²

Neni 10

Lirimi nga taksat e ndërtimit, rrënit, ndikimit në infrastrukturë, dhe rritjes së densitetit

- Nga pagesa e taksës së ndërtimit, rrënit, ndikimit në infrastrukturë dhe rritjes së densitetit janë të liruara kategoritë ndërtimore në vijim:
 - Ndërtimet të cilat financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës,
 - Ndërtimet të cilat financohen përmes donacioneve apo granteve për interes të përgjithshëm në pajtim me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike,
 - Ndërtimet për banim individual për përfituesit e skemës së ndihmës sociale,
 - Rindërtimet e ndërtimeve të shkaktuara si rezultat i luftës, trazirave shoqërore ose forcës madhore, dhe
 - Ndërtimet e ndërtesave: arsimore, kulturore, fetare, sportive, shëndetësore, qendrat rekreative dhe ndërtesave tjera që kanë karakter social, të cilat ndërtohen me mjete

buxhetore (investim i komunitetit) apo me donacione vendore ose të huaja e që janë të interesit të përgjithshëm.

Neni 10

10.1. TARIFAT DHE NGARKESAT PËR NDIKIMIN NË MJEDIS SIPAS UA 06/2018 për ndëshkimet me gjoba mandatore (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor)

1. Veprimet ndëshkuese me gjobë mandatore dhe vlera e gjobës për personin janë:

1.1. me gjobë në vlerë prej 20 € i shqiptohet personit nëse:

- 1.1.1. Hedhë cigaren në rrugë ose sipërfaqe publike;
- 1.1.2. Hedhë çamçakëz në rrugë ose në sipërfaqe publike;

1.2. me gjobë në vlerë prej 30 € i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:

- 1.2.1. Hedhë ambalazhë dhe mbeturina letre në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 1.2.2. Hedhë ambalazhë dhe mbeturina plastike në rrugë ose sipërfaqe publike;
- 1.2.3. Hedhë ambalazhë dhe mbeturina qelqi dhe metali në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 1.2.4. Hedhë kanaçe në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 1.2.5. Hedhë mbeturina ushqimore në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 1.2.6. Hedhë çfarëdo lloj mbeturine në rrugë ose në sipërfaqe publike;

1.3. me gjobë në vlerë prej 40 € i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:

- 1.3.1. Hedhë mbeturina komunale jashtë kontejnerit për mbeturina komunale;
- 1.3.2. në kontejner të mbeturinave merr ose shkapërderdh- nxjerr mbeturina prej kontejnerit jashtë;
- 1.3.3. Hedhë mbeturina të përziera në kontejnerët ku janë të klasifikuara mbeturinat si:
 - 1.3.3.1. Organike, qelqi, letra, plastika, metali,
 - 1.3.3.2. Mbeturinat nga copëtimi i drunjëve, i lënë në rrugë ose në sipërfaqe publike;
 - 1.3.3.3. Mbeturinat nga thëngjilli, i lënë në rrugë ose sipërfaqe publike;
 - 1.3.3.4. nuk e pastron jashtëqitjen e kafshës së tyre në rrugë, në trotuare, parkingje, objekte të banimit kolektiv dhe objekte tjera publike.

1.4. me gjobë në vlerë prej 50 € i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:

- 1.4.1. Hedhë cigare në rrugë nga automjeti në lëvizje;
- 1.4.2. Hedhë ambalazhë dhe mbeturina letre në rrugë nga automjeti në lëvizje;
- 1.4.3. Hedhë ambalazhë dhe mbeturina plastike në rrugë nga automjeti në lëvizje;
- 1.4.4. Hedhë ambalazhë dhe mbeturinë qelqi në rrugë nga automjeti në lëvizje;
- 1.4.5. Hedhë kanaçe në rrugë nga automjeti në lëvizje;
- 1.4.6. Hedhë mbeturina ushqimore në rrugë nga automjeti në lëvizje;
- 1.4.7. Dëmton kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.4.8. i ndërron vendin kontejnerëve për mbeturina komunale;
- 1.4.9. Hedhë akumulatore në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.4.10. Hedhë pajisje elektrike dhe elektronike në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.4.11. Hedhë mbeturina të automjeteve të vjetra në kontejnerët për mbeturina komunale, rrugë, në natyrë dhe sipërfaqe publike;
- 1.4.12. Hedhë ambalazhë dhe mbeturina letre në natyrë;
- 1.4.13. Hedhë ambalazhë dhe mbeturina plastike në natyrë;
- 1.4.14. Hedhë ambalazhë dhe mbeturina qelqi në natyrë;

- 1.4.15. Hedhë kanace në natyrë;
- 1.4.16. Hedhë mbeturina ushqimore në natyrë;
- 1.4.17. Hedhë mbeturina nga kopshtet në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.5. me gjobë në vlerë prej 70 € i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:**
- 1.5.1. Hedhë çfarëdo lloj mbeturine nga ballkoni ose dritarja e objektit;
- 1.5.2. Hedhë mbeturina në pusetat për kanalizim;
- 1.5.3. Hedhë mbeturina nga ambalazha e materialit ndërtimor jashtë kontejnerëve (ambalazhë letre, metali, plastike dhe materiale të ndryshme);
- 1.5.4. Hedhë mbeturina të ngjyrave në kanalizim;
- 1.5.5. Hedhë mbeturina të ngjyrave në kontejner për mbeturina komunale;
- 1.5.6. Hedhë mbeturina të vajit në tokë nga pakujdesia;
- 1.5.7. Hedhë mbeturinat medicinale në kontejner për mbeturina komunale;
- 1.5.8. Hedhë mbeturina të stallave në afërsi të rrugës brenda vendbanimit (nuk nënkupton shpërndarjen e plehut në ara);
- 1.5.9. Hedhë mbeturina në pronën e tjetrit;
- 1.5.10. Hedhë pajisje elektrike dhe elektronike në sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 1.5.11. Hedhë bateri ose akumulatorë në sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 1.5.12. Hedhë cigaren e ndezur në kontejnerin për mbeturina komunale;
- 1.5.13. Hedhë hirin e nxehtë në kontejnerin për mbeturina;
- 1.6. Me gjobë në vlerë prej 90 € i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:**
- 1.6.1. Hedhë mbeturina nga materialet ndërtimore jashtë vendeve ose kontejnerëve të caktuar nga autoriteti komunal për mbeturina të materialeve ndërtimore;
- 1.6.2. Hedhë mbeturina nga materialet ndërtimore në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.6.3. Hedhë mbeturina medicinale në sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 1.6.4. Hedhë mbeturina medicinale jashtë kontejnerëve për këto lloje të mbeturinave;
- 1.6.5. Hedhë mbeturina të vëllimshme në kontejner për mbeturina komunale. Sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 1.6.6. Hedhë lloj tjetër të mbeturinave në sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 1.6.7. Hedhë mbeturina të përziera me vaj në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.6.8. Mbeturinat drunore nga krasitja e bimëve ose drunjëve nuk i mbledh nga rruga ose hapësira publike në kohën e krasitjes;
- 1.6.9. Hedhë mbeturina drunore nga krasitja e bimëve ose drunjëve në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.6.10. Djegë mbeturina komunale në kontejnerë;
- 1.6.11. Hedhë broshura, fletëpalosje jashtë vendeve të përcaktuara nga komuna.
- 1.7. me gjobë në vlerë prej 100 € i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:**
- 1.7.1. Hedhë çfarëdo lloj mbeturine në ujëra të përroskave, lumenjëve, liqeneve ose sipërfaqeve të tjera me ujë;
- 1.7.2. Hedhë çfarëdo lloj mbeturine në brigjet e përroskave, lumenjëve, liqeneve ose sipërfaqeve të tjera me ujë;
- 1.7.3. Hedhë mbeturina të vajit në sipërfaqe publike, kanalizim, në rrugë ose në natyrë;
- 1.7.4. Hedhë mbeturina të përziera me vaj në sipërfaqe publike, në rrugë ose natyrë;
- 1.7.5. Hedhë mbeturina të gomës dhe goma të automjeteve në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë;
- 1.7.6. Djegë mbeturina komunale në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë;

- 1.7.7. Djegë goma, goma të automjeteve ose mbeturina tjera prej gome, në hapësira private, publike, në rrugë ose në natyrë;
- 1.7.8. Djegë mbeturina të ndryshme prej plastike, në hapësira private, publike, në rrugë ose në natyrë;
- 1.7.9. Djegë mbeturina të ndryshme prej letre në sipërfaqe publike, në rrugë ose natyrë;
- 1.7.10. Djegë vajra ose mbeturina të vajrave në hapësira private, publike, në rrugë ose në natyrë;
- 1.7.11. Djegë mbeturinat të ndryshme në sipërfaqet e tokave bujqësore;
- 1.7.12. Derdhë çfarëdo materiali në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë me ç'rast prej saj krijohet mbeturinë ose ndotje.

Neni 11

11.1 TARIFAT DHE GJOBAT PËR INSPEKTORIN NDËRTIMOR

Bazuar në ligjin për Ndërtim nr: 04/L-110 Inspektori i ndërtimit ka këto Kompetenca:

Mbikëqyrja inspektuese: Funksionin e inspektimit të paraparë me këtë ligj dhe akte tjera nënligjore e kryen Inspekcioni Ndërtimor i Ministrisë dhe Inspekcioni Ndërtimor i Komunave brenda kompetencave të tyre.

Autorizimet e Inspektorit: a) Inspekcioni përkatës ndërtimor ka të drejtë të bëjë inspektim të çdo objekti ndërtimor brenda kompetencave të tij në pajtueshmëri me këtë ligj.

b) Poseduesi i lejes ndërtimore dhe kontraktuesi duhet t'i sigurojnë qasje të arsyeshme inspekcionit ndërtimor kur ai i kryen detyrat e tij sipas këtij ligji.

Në bazë të ligjit për Ndërtim 04/L-110 Neni 35 për Gjobat dhe Ndëshkimet pika 1, parasheh: Mënyra, procedurat, ekzekutimi dhe shumat e gjobave ndaj pjesëmarrësve në ndërtim përcaktohen nga Ministria me akt të veçantë administrativ dhe rishikohet dhe miratohet për çdo vit dhe publikohen në Gazetën Zyrtare.

Poseduesi i lejes ndërtimore do të gjobitet nëse:

- a) Puna ndërtimore krijon rrezik për personat tjerë, dhe nëse nuk siguron, rrethon ose shënjon dukshëm me shenja treguese rreziqet që mund t'u kanosen kalimtarëve;
- b) Nuk vendos në vend ndërtim tabelën informuese, apo
- c) Nuk ndërmerr masa për sigurimin e ndërtimit dhe ndërtimeve fqinje.

Neni 12

DREJTORIA PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT

Bazuar ne nenin 62, paragrafi 62.3 të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 8 të ligjit nr. 03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal, taksat për shërbime nga DAKRS janë si vijon:

1	Pagesat për dokumentacionin shkollor.	
1.1	Pagesa për nxjerrjen e diplomës dublikatë.	1€
1.2	Pagesa për nxjerrjen e dëftesës dublikatë për klaset 10-12.	1€
1.3	Certifikatë për kryerjen e klasës 1-5 dublikatë.	1€
1.4	Dëftesë për kryerjen e klasës 6-9, dublikatë.	1€
1.5	Vërtetimet e ndryshme të cilat i kërkojnë ish nxënësit për nivelin e arsimit fillor i mesëm i ulët dhe i arsimit i mesëm i lartë.	1€
1.6	Për dëftesat e lëshuara kandidatëve që kanë kryer mësimin e obliguar sipas sistemit të vjetër të arsimit.	1€
1.7	Referencë për mësimdhënës	1€
2	Tarifa Mujore në Institucionin Parashkollor	
2.1	Për një fëmijë	50€
2.2	Për dy fëmijë (njëri me tarifë të plotë dhe i dyti 20% më pak).	90€
2.3	Për tre fëmijë (njëri me tarifë të plotë dhe i dyti 30% më pak, i treti 50% më pak).	110€
3	Kategoria e liruar nga pagesa	
3.1	Fëmijët me nevoja të veqanta arsimorë	0
3.2	Fëmija i braktisur dhe pa përkujdesje prindërore	0
3.3	Fëmijët e nënave vetëmajtës	0
3.4	Fëmijët me prinder të sëmurë, me sëmundje të rend (kancer, leokimi etj).	0

Neni 13

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

13.1 MBLEDHJA E PAGESAVE PËR REGJISTRIMIN VJETOR TË AUTOMJETEVE NË TERRITORIN E KOMUNËS

Për automjete deri 3.5 t.....	Tarifa	10.00 €
Për automjete mbi 3.5 t.....	Tarifa	20.00 €

Komuna është e pajtimit që të hyrat nga pagesat vjetore për regjistrimin e automjeteve të shfrytëzohen për mirëmbajtjen dhe ndërtimin e rrugëve Komunale dhe vend parkimeve.

Nga pagesa janë të liruar automjetet e:

- Mbrojtjes shëndetësore dhe sociale,
- Organizatave humanitare,
- Organeve shtetërore dhe organizatat publike komunale.

13.2. Ngarkesat për marrjen, bartjen dhe magazinimin e automjeteve të parkuara në vende të ndaluara.

Për çdo automjet tarifa 50.00 €

Për ngarkesat nga pika 13.2 Komuna do të bëjë kontratë me kompanitë e autorizuar për marrjen, bartjen dhe magazinimin e automjeteve.

Neni 14

14.1. CAKTIMI I GJOBAVE NË TRAFIK BRENDA KUFIJVE TË KOMUNËS

Kjo pikë është e rregulluar me në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi nga niveli Qendror. Gjohat e shqiptuara për shkelje kundërvajtëse në trafik i takojnë komunës. Alokimi i mjeteve të inkasuara bëhet sipas dispozitave të rregullativës së Thesarit

Neni 15

15.1. RREGULLORJA E TATIMIT NË PRONËN E PALUAJTSHME

Inkasimi i të hyrave vetanake nga Tatimi në Pronë është e rregulluar me Rregullore e Tatimit në Pronë e paluajtshme komunale bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

II. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 16

Të gjitha subjektet ekonomike, shfrytëzuesit e hapësirave publike dhe personat tjerë, të cilët sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje janë obligues të ngarkesave të parapara, obligohen që në afatin brenda 15 ditësh nga dita e publikimit të kësaj Rregulloreje të bëjnë paraqitjen e obligimeve të tyre.

Kërkesën për lejen e punës, nëse me leje nuk disponon atëherë të bëjë kërkesën për marrjen e lejes për shfrytëzimin e hapësirave publike dhe të paraqes akte të tjera në pajtueshmëri me këtë Rregullore.

Neni 17

Nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje për 15 ditët vijuese nuk do të aplikohen masat ndëshkuese.

III. ANKESAT DHE MBROJTJA GJYQËSORE

Neni 18

Personi mund të bëjë ankesë ndaj vendimit të lëshuar nga Komuna, nëse ai ose ajo deklaron se i janë shkelur të drejtat e tij. Ankesa nuk e shtyn afatin e pagesës të caktuar në vendim.

Neni 19

Ndaj vendimit përfundimtar të Komunës mund të ushtrohet ankesë drejtuar Gjykatës Themelore të Pejës- Dega në Deqan.

IV. DISPOZITA E FUNDIT

Neni 20

Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushon aplikimi i Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha komunale për vitin 2026.

Neni 21

Kjo Rregullore hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Junikut dhe 15 ditë pas vlerësimit nga Komisioni për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të Komunave në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit lokal.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Leonard Lolluni

Datë: 00//00//0000



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Datë/ Datum/ Date:	11.09.2026
Për/ Za/ To:	z. Leonard Ljolluni – Kryesues i Kuvendit Komunal
Përmes/ Putem/ Via:	z. Ruzhdi Shehu – Kryetar i Komunës së Junikut
Nga/ Od/ From:	z. Besart Tofaj - Nënkrjetar i Komunës së Junikut
Tema/ Subjekti/ Subject:	Kërkesë

Tnderuar,

Bazuar në Vendimin nr. 007/32, të datës 29.05.2026, të Kuvendit të Komunës së Junikut, për iniciimin e procedurave për plotësimin dhe ndryshimin e "Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve", si dhe në bazë të Vendimit nr. 01/144, të Kryetarit të Komunës, të datës 03.09.2026 për formimin e Grupit Punues për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

Grupi Punues i përbërë nga:

- Besart Tofaj – Kryesues;
- Demokrat Ganiçaj – Anëtar;
- Leonora Shehu – Anëtare;
- Arton Krasniqi – Anëtar;
- Arten Hamza – Anëtar;
- Valbona Gacaferi – Anëtare;
- Rrustem Pëpshi – Anëtar.

Grupi punues në dy takimet e mbajtura ka shqyrtuar Rregulloren për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe ka propozuar plotësimin e saj me katër (4) nene të reja.

Nenet e reja të sugjeruara për t'u shtuar janë:

- Neni 22 – Subvencionet për gratë lehona;
- Neni 23 – Kriteret dhe dokumentacioni për subvencionet për gratë lehona;
- Neni 24 – Subvencionet për mbulimin e shpenzimeve të varrimit;
- Neni 25 – Kriteret dhe dokumentacioni për subvencionet për mbulimin e shpenzimeve të varrimit.

Krahas kësaj, janë përmirësuar edhe gabimet drejtshkrimore, si dhe janë plotësuar disa paragrafë të disa neneve të tjera dhe është ristrukturuar renditja e neneve, me qëllim të funksionimit dhe implementimit sa më të lehtë të neneve 22, 23, 24 dhe 25, por edhe të Rregullores në përgjithësi.

Andaj, kërkojmë nga Kuvendi Komunal që të shqyrtojë dhe miratojë në leximin e parë plotësim-ndryshimet e "Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve".

Me respekt!



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna Junik – Opština Junik – Municipality of Junik

(DRAFT)

**RREGULLORE PËR KUSHTET, KRITERET DHE
PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE**

Junik, 2026

Në bazë të nenit 12, paragrafët 1 dhe 2, pika c, të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008, dt. 4 qershor 2008), neni 17 par. 1 dhe 2, i Ligjit nr. 03/L-048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe në zbatim të nenit 36, par. 3, të Rregullës financiare nr. 01/2013 – MF - Shpenzimi i parave publike, dhe të nenit 22, pika 3 të Statutit të Komunës së Junikut Nr. 001/3127, të datës 29.10.2010, Kuvendi i Komunës së Junikut, në mbledhjen e mbajtur më datë: 00.00.2026, miratoi këtë:

Rregullore për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës të ndajë mjete financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve për fushat e cekura në këtë rregullore për personat fizikë dhe juridikë.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga organet dhe trupat komunale gjatë ndarjes së subvencioneve për përfituesit.

Neni 2

Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

Subvencionet - për kuptim të kësaj rregulloreje subvencionet përfshijnë transferet e njëanshme, të pakthyeshme të mjeteve buxhetore të institucionit, në llogarinë rrjedhëse të përfituesve, të ardhurat e të cilëve nuk mbulojnë shpenzimet e caktuara përkatëse për arritjen e një qëllimi të ligjshëm për interes publik.

Pagesa e pakthyeshme - është e njëanshme atëherë kur nuk ka mallra dhe shërbime që rrjedhin si kompensim ose kundërvlerë për pagesën.

Përfituesi - nënkupton personat fizikë dhe juridikë që përfitojnë mjete financiare nga kategoria e subvencioneve të planifikuara në Buxhetin e Komunës dhe në pajtim me Ligjin për ndarjet buxhetore.

Banor rezident - nënkupton personin që jeton dhe vepron në Komunë dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës

Neni 3

Limitet buxhetore

1. Komuna ndan subvencione duke u bazuar në Ligjin e buxhetit për vitin fiskal për të cilin ndahen subvencionet dhe vetëm në masën e përcaktuar në këtë ligj.
2. Ndarja e subvencioneve për OJQ-të do të bëhet në përputhje me nenin 2 pika 5 të Rregullores MF-Nr-04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës të ndajë mjete financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve për fushat e cekura në këtë rregullore për personat fizikë dhe juridikë.

Neni 4

Rregullat e përgjithshme të aplikimit për subvencione

1. Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për persona fizikë dhe juridikë mbi bazën e kërkesës së tyre dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Personi fizik dhe juridik mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna nëse i ka të përfunduara obligimet ndaj Komunës.
3. Kushtëzimi me përfundimin e obligimeve ndaj institucioneve të tjera të personit fizik dhe juridik mund të përcaktohet sipas fushave specifike nga vetë Komuna.

Neni 5

Procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencioneve

1. Procedura e ndarjes së subvencioneve nga Komuna mund të zhvillohet mbi bazën e thirrjes publike apo në raste të veçanta në bazë të kërkesës së arsyetuar atëherë kur lejohet me dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike të Komunës përcaktohet qartë fusha e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata të tjera me rëndësi.
3. Shqyrtimi i kërkesave dhe ndarja e subvencioneve mbi bazën e thirrjes publike zhvillohet sipas dispozitave të parapara të kësaj Rregulloreje.
4. Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për ndarje të subvencioneve jashtë thirrjes publike të Komunës bëhet brenda 15 ditëve të punës nga parashtrimi i kërkesës.

Neni 6

Përfshirjet nga ndarja e subvencioneve

1. Përfutues të subvencioneve të ndara nga Komuna nuk mund të jenë personat fizikë jorezidentë të Komunës.
2. Personi fizik apo juridik vetëm një herë në vit mund të jetë përfutues i subvencioneve të ndara nga Komuna.
3. Përfshirje nga paragrafi 2 i këtij Neni bëjnë subvencionet e ndara për persona fizikë në fushën e shëndetësisë dhe nevoja ushqimore (mirëqenie sociale).
4. Nëse me fajn e përfutuesit nuk përmbushen obligimet e përcaktuara në vendimin apo me marrëveshjen për ndarjen e subvencioneve, për 3 vitet e ardhshme përfutuesi humb të drejtën në përfutim nga secila kategori e subvencioneve.

Neni 7

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve

1. Kryetari i Komunës emëron komisione të përkohshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve në përbërje të përfaqësuesve nga fushat specifike.
2. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve veprojnë në pajtim me parimet e përgjithshme të ligjshmërisë dhe konform autorizimeve, që jepen nga Kryetari i Komunës.
3. Përbërja e komisionit duhet të jetë prej 5 anëtarëve, njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë zyrtar i financave dhe një anëtar mund të jetë nga shoqëria civile që ka fushëveprim të ngjashëm me fushën që do të ndahet subvencioni.
4. Kryetari dhe anëtarët e tjerë të komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve duhet të jenë shërbyes civilë të Komunës, me përjashtim të anëtarit të shoqërisë civile.
5. Përbërja e komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.
6. Anëtarët e komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve mbajnë përgjegjësinë për zbatimin e drejtë të kritereve për ndarje të subvencioneve.

Neni 8

Vlerësimi i kërkesave dhe vendimmarrja

1. Komisioni bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve brenda afatit prej 15 ditëve të punës pas përfundimit të afatit të shpalljes publike.

2. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve veprojnë në pajtim me legjislacionin për financat publike dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje si dhe legjislacionin në fuqi.
3. Rekomandimet e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të komisionit.
4. Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij, i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit.
5. Komisioni i rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve të subvencioneve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve dhe në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, si dhe i rekomandon marrjen e vendimit për ndarje të subvencioneve.
6. Bazuar në rekomandimin e komisionit, Kryetari merr vendim për ndarjen e subvencioneve dhe brenda pesë ditëve të punës, lista e përfituesve të përzgjedhur publikohet në ueb faqen zyrtare si dhe në tabelën e shpalljeve publike të Komunës.
7. Të gjithë aplikuesit njoftohen për të drejtën dhe procedurën e parashtrimit të ankesës përmes listës së publikuar.
8. Kërkesat që nuk i plotësojnë kriteret për subvencione do të refuzohen nga Kryetari me rekomandim të komisionit.
9. Kryetari mund të kërkojë që komisioni për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve të bëjë rivlerësimin e kërkesave apo të anulojë gjithë procesin e vlerësimit dhe të caktojë Komision të ri për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.
10. Kryetari merr vendim përfundimtar për ndarjen e subvencioneve, në përputhje me rekomandimin e komisionit, në afat prej 5 ditëve të punës pas përfundimit të afatit të paraqitjes së ankesave të përcaktuar sipas Nenit 10 të kësaj Rregulloreje.

Neni 9

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve

1. Kryetari i Komunës emëron komisione me mandat trevjeçar për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve në përbërje të përfaqësuesve nga fushat specifike.
2. Kryetari dhe anëtarët e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve duhet të jenë shërbyes civilë.
3. Komisioni do të jetë në përbërje prej 3 anëtarëve.

4. Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit.
5. Një anëtar i komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve duhet të jetë zyrtar ligjor i njësisë përkatëse.
6. Anëtarë të komisionit për vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve nuk mund të jenë zyrtarët të cilët kanë qenë pjesë e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.
7. Përbërja e komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.

Neni 10 **Parashtrimi dhe zgjidhja e ankesave**

1. Ankesa parashtrohet në afat prej 5 ditëve të punës pas njoftimit të vendimit të Kryetarit të Komunës për mosndarjen e subvencioneve.
2. Komisioni duhet të bëjë shqyrtimin e ankesave dhe të marrë vendim në afat prej 10 ditëve të punës pas përfundimit të afatit kohor për paraqitje të ankesave.
3. Komisioni për ankesa gjatë vendimmarrjes vepron në bazë të ligjit për procedurën administrative dhe dispozitave të kësaj rregulloreje.
4. Vendimet e komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të komisionit.
5. Komisioni i ankesave ka të drejtë të:
 - 5.1. të refuzojë ankesën e palëve si të pabazuar; dhe
 - 5.2. të kërkojë nga komisioni vlerësues të rishqyrtojë kërkesat e aplikuesve.

Neni 11 **Ekzekutueshmëria e vendimit**

1. Vendimi i Kryetarit për ndarjen e subvencioneve bëhet i ekzekutueshëm nëse:
 - 1.1. nuk është parashtruar ankesa sipas paragrafit 1 të nenit 10;
 - 1.2. me vendimin e komisionit të ankesave refuzohet ankesa.

Neni 12

Shpallja Publike për ndarjen e subvencioneve

1. Procesi i ndarjes së subvencioneve fillon përmes shpalljeve publike të cilat publikohen në ueb-faqen e komunës, mediat lokale, në tabelat e shpalljeve si dhe në vendet e frekuentuara në territorin e komunës.
2. Në shpallje përcaktohen saktë kriteret dhe procedurat për të aplikuar për ndarjen e subvencioneve të cilat përcaktohen sipas kësaj rregulloreje.
3. Shpallja publike qëndron e publikuar së paku 10 ditë pune nga data e shpalljes.

Neni 13

Marrëveshja për subvencionim

1. Për realizimin e subvencioneve duhet të lidhet një marrëveshje me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrat mes komunës dhe përfituesit të subvencionit.
2. Në çdo rast të subvencionimit duhet të lidhet Marrëveshja.
3. Marrëveshja e paraparë me paragrafin 2 të këtij neni nuk aplikohet për subvencionet që jepen për trajtimin e sëmundjeve shëndetësore, për shpërblimin e studentëve, mësimitdhënësve, sportistëve për sukseset e arritura në garat kombëtare apo ndërkombëtare, për gratë lehona si dhe për mbulimin e shpenzimeve të varrimit.
4. Marrëveshja duhet të përcaktojë subjektet nënshkruese të marrëveshjes, qëllimin, shumën e mjeteve financiare, afatet kohore, detyrat dhe përgjegjësitë e palëve, mbikëqyrjen, formën e subvencionimit, raportimin, hyrjen në fuqi si dhe pjesë tjera relevante për marrëveshjen.
5. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në afat prej 10 ditëve të punës pas shpalljes së vendimit përfundimtar për ndarje të subvencioneve.

Neni 14

Subvencionet për Arsim

1. Komuna mund të ndajë subvencione për arsim duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1. Bursa për studentë;
 - 1.2. Bursa për nxënës në shkollë të mesme;

- 1.3. Bursa për nxënës në shkollë fillore;
- 1.4. Kuadrot deficitare;
- 1.5. Nxënësit me nevoja të veçanta;
- 1.6. Gara apo kuize (aktivitete jashtëmësimore);
- 1.7. Botimin e librave/revistave; dhe
- 1.8. Nxënësit, mësindhënësit, studentët që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

2. Kategoritë dhe shumat e subvencionimit do të përcaktohen me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës për çdo vit fiskal.

Neni 15

Kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e bursave

1. Kryetari i Komunës me vendim të veçantë përcakton kritere të qarta për dhënien e bursave duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në:
 - 1.1. Notën mesatare;
 - 1.2. Numrin e studentëve/nxënësve në familje;
 - 1.3. Kategoritë e dala nga lufta (vetëm për studentë);
 - 1.4. Banimin në zona rurale;
 - 1.5. Rezultatet në gara; dhe
 - 1.6. Gjendjen ekonomike.
2. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të bursave përfshijnë, por duke mos u kufizuar:
 - 2.1. Dokumenti i identifikimit;
 - 2.2. Certifikata e notave;
 - 2.3. Certifikata e vitit kalendarik të studimeve;
 - 2.4. Certifikata e vendbanimit;
 - 2.5. Dëshmi mbi gjendjen ekonomike;
 - 2.6. Dëshmi se prindërit janë kategori të dala nga lufta; dhe
 - 2.7. Dëshmi për rezultatet në gara.
3. Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i bursës nëse brenda vitit të njëjtë fiskal ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti qendror ose ndonjë donator tjetër për fushën e njëjtë.
4. Komuna duhet të bëjë shpalljen publike për dhënien e bursave e cila publikohet në ueb faqen e Komunës, në vendet e frekuentuara, mediat sociale dhe në mediat lokale.

Neni 16

Subvencionet për zhvillim ekonomik

1. Komuna mund të ndajë subvencione për zhvillim ekonomik duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1. Zejet tradicionale;
 - 1.2. Aksesorë;
 - 1.3. Agrobizneset;
 - 1.4. Teknologji informative;
 - 1.5. Ndërmarrjet publike;
 - 1.6. Bizneset inovative;
 - 1.7. Ndërmarrjet sociale;
 - 1.8. Aktivitetet e shoqatave të cilat ndihmojnë dhe promovojnë zhvillimin ekonomik dhe turizmin;
 - 1.9. Inkubatorët e biznesit;
 - 1.10. Bizneset e reja apo fillestare;
 - 1.11. Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve njerëzore për zhvillim të biznesit; dhe
 - 1.12. Aktivitetet për hulumtime të tregut të grupeve të studentëve.
2. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik mund të jenë vetëm bizneset që veprojnë në territorin e Komunës së Junikut.
3. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik nuk mund të jenë bizneset që kanë obligime financiare të papaguara komunale dhe ATK-së.

Neni 17

Përparësitë gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik, në kushte të barabarta Komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:
 - 1.1. Bizneseve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që krijojnë punësim;
 - 1.2. Grave, të rinjve, zonave rurale, personave me nevoja të veçanta dhe komuniteteve;
 - 1.3. Bizneseve që kanë siguruar bashkëfinancim nga palë të treta me një përqindje (%) të caktuar nga vlera e projektit. Përqindja e kërkuar e bashkëfinancimit do të caktohet varësisht nga mundësitë buxhetore të Komunës së Junikut;
 - 1.4. Bizneseve të cilat posedojnë dëshmi apo certifikime profesionale;
 - 1.5. OJQ-ve të cilat aplikojnë me projekte biznesi të cilat mundësojnë gjenerim të vendeve të punës;
 - 1.6. Bizneseve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga Komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencioni për zhvillim ekonomik të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

2. Bizneset e përcaktuara në paragrafin 1.3 dhe 1.4 të këtij neni mund të aplikojnë për ndarje të subvencioneve edhe jashtë periudhës së shpalljes publike me kërkesë të arsyetuar.

Neni 18

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione për zhvillim ekonomik

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për zhvillim ekonomik përfshijnë, por duke mos u kufizuar:

- 1.1. Plani i biznesit;
- 1.2. Dokumenti identifikues;
- 1.3. Certifikatën e vendbanimit (për persona fizik);
- 1.4. Certifikata e biznesit;
- 1.5. Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
- 1.6. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
- 1.7. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;
- 1.8. Dëshmi për bashkëfinancim (nëse ka bashkëfinancim);
- 1.9. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;
- 1.10. Konfirmimin e regjistrimit të xhirollogarisë bankare të aplikuesit në platformën e-Kosova.

Neni 19

Subvencionet për bujqësi

1. Komuna mund të ndajë subvencione për bujqësi duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:

- 1.1. Projekte të fermerëve, shoqatave, kooperativave bujqësore, në fushat bujqësore me prioritet për Komunën;
- 1.2. Organizimin e panaireve, seminareve, vizitave studimore;
- 1.3. Mbështetjen e projekteve me bashkëfinancim; dhe
- 1.4. Projekte në sektorin e pylltarisë.

2. Gjatë ndarjes së subvencioneve në bujqësi, në kushte të barabarta Komuna u jep përparësi:

- 2.1. Zonave me prioritet të identifikuara nga Komuna;
- 2.2. Pjesëmarrjes së fermerit në bashkëfinancim me një përqindje (%) të caktuar nga vlera e projektit. Përqindja e kërkuar e bashkëfinancimit do të caktohet varësisht nga mundësitë buxhetore të Komunës;
- 2.3. Grave, të rinjve, personave me nevoja të veçanta dhe minoritetëve; dhe
- 2.4. Aplikuesve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga Komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencioni për bujqësi të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

Neni 20

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione në bujqësi

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat juridik përfshijnë, duke mos u kufizuar:

- 1.1. Numri identifikues i fermerit (NIF);
- 1.2. Certifikata e biznesit;
- 1.3. Projekti dhe plani financiar;
- 1.4. Fletëposedim për patundshmëri;
- 1.5. Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
- 1.6. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
- 1.7. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;
- 1.8. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;
- 1.9. Konfirmimin e regjistrimit të xhirollogarisë bankare të aplikuesit në platformën e-Kosova;
- 1.10. Dokumenti identifikues i personit të autorizuar për tërheqjen e mjeteve dhe autorizimit;
- 1.11. Dëshmi se nuk është përfitues i një subvencioni të ndarë nga pushteti qendror në këtë fushë brenda vitit fiskal.

2. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat fizik përfshijnë, duke mos u kufizuar:

- 2.1. Numri identifikues i fermerit (NIF);
- 2.2. Projekti dhe plani financiar;
- 2.3. Fletëposedim për patundshmëri;
- 2.4. Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
- 2.5. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
- 2.6. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;
- 2.7. Konfirmimin e regjistrimit të xhirollogarisë bankare të aplikuesit në platformën e-Kosova.

Neni 21

Subvencionet për shëndetësi dhe mirëqenie sociale

1. Komuna ndan subvencione për banorët rezidentë për përballimin e shpenzimeve të shërimit sipas kritereve të përcaktuara nga drejtoria përgjegjëse për shëndetësi.

2. Subvencionet për shëndetësi jepen për:

- 2.1. Rastet e rënda shëndetësore;
- 2.2. Rastet e sëmundjeve kronike, por pa burim të të ardhurave;
- 2.3. Trajtimi jashtë vendit;

2.4. Fushatat e vetëdijesimit për shëndetin publik;

2.5. Mirëqenie sociale.

3. Gjatë ndarjes së subvencioneve në shëndetësi, në kushte të barabarta Komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:

3.1. Numri i anëtarëve të familjes;

3.2. Çështja e banimit;

3.3. Kostoja e trajtimit;

3.4. Gjendja ekonomike familjare;

3.5. Trajtimi në institucionet private (nëse një sëmundje e tillë nuk mund të trajtohet në institucionet publike).

4. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për shëndetësi nga personat fizik përfshijnë, duke mos u kufizuar:

4.1. Diagnoza e mjekut specialist;

4.2. Dokumenti i identifikimit;

4.3. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;

4.4. Konfirmimin e regjistrimit të xhirollogarisë bankare të aplikuesit në platformën e-Kosova;

4.5. Dëshmia e shpenzimeve mjekësore.

5. Personat, për subvencionet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni mund të ndahen edhe pa shpallje publike por me kërkesë të arsyetuar.

Neni 22

Subvencionet për gratë lehona

1. Komuna e Junikut mund të ndajë subvencione për gratë lehona, me qëllim të mbështetjes së tyre dhe të familjeve pas lindjes së fëmijës.

2. Subvencionimi realizohet për çdo fëmijë të lindur, në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë Rregullore.

3. Në rast të lindjes së binjakëve, trinjakëve ose më shumë fëmijëve në të njëjtën lindje, subvencionimi realizohet për secilin fëmijë.

4. Shuma e subvencionit për vitin përkatës përcaktohet nga Kryetari i Komunës, në bazë të mundësive financiare të Komunës.

5. Subvencionet ndahen nga mjetet e planifikuara në Buxhetin e Komunës së Junikut për vitin përkatës.

6. Thirrja publike për subvencionet për gratë lehona shpallet në fillim të vitit përkatës dhe mbetet e hapur gjatë tërë vitit. Kërkesat e pranuar shqyrtohen nga komisioni dhe pagesa e subvencionve realizohet pas miratimit të rekomandimit të komisionit nga organi kompetent.

Neni 23

Kriteret dhe dokumentacioni për subvencionet për gratë lehona

A) Kriteret

Për të përfituar subvencionin për gratë lehona, aplikuesja duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Të jetë shtetase e Republikës së Kosovës;
2. Të ketë vendbanim në Komunën e Junikut;
3. Lindja të jetë kryer ose raportuar në një institucion shëndetësor të licencuar në Republikën e Kosovës dhe të jetë e regjistruar në regjistrat zyrtarë të gjendjes civile të Republikës së Kosovës;
4. Të paraqesë kërkesën brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e lindjes së fëmijës;
5. Për të njëjtën lindje dhe për të njëjtin fëmijë të mos ketë përfituar më parë subvencion nga Komuna e Junikut.

B) Dokumentacioni

Për aplikim për subvencion, aplikuesja duhet të dorëzojë:

1. Kërkesën për subvencion;
2. Kopjen e dokumentit të identifikimit;
3. Certifikatën e lindjes së fëmijës;
4. Dëshminë e vendbanimit të lehonës, nëse vendbanimi nuk mund të verifikohet përmes regjistrave zyrtarë;
5. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e lehonës;
6. Konfirmimin e regjistrimit të xhirollogarisë bankare të lehonës në platformën e-Kosova;
7. Dokumente të tjera të nevojshme për verifikimin e kërkesës.

Neni 24

Subvencionet për mbulimin e shpenzimeve të varrimit

1. Komuna e Junikut mund të ndajë subvencione për mbulimin e një pjese të shpenzimeve të shërbimeve të varrimit për personat e ndjerë të cilët, në momentin e vdekjes, kanë pasur vendbanim në Komunën e Junikut.
2. Subvencionimi realizohet për rastet kur varrimi kryhet në varrezat e qytetit të Junikut (Rogopeq), me qëllim të stimulimit dhe orientimit të qytetarëve për shfrytëzimin e varrezave të qytetit.
3. Subvencioni i dedikohet anëtarit të familjes së të ndjerit ose personit i cili ka bartur shpenzimet e shërbimeve të varrimit.
4. Për rastet kur varrimi kryhet jashtë varrezave të qytetit të Junikut (Rogopeq), nuk realizohet e drejta për subvencion sipas këtij neni.
5. Shuma e subvencionit për vitin përkatës përcaktohet nga Kryetari i Komunës, në bazë të mundësive financiare të Komunës.
6. Subvencionet ndahen nga mjetet e planifikuara në Buxhetin e Komunës së Junikut për vitin përkatës.
7. Thirrja publike për subvencionet për mbulimin e shpenzimeve të varrimit shpallet në fillim të vitit përkatës dhe mbetet e hapur gjatë tërë vitit. Kërkesat e pranuar shqyrtohen nga komisioni dhe pagesa e subvencioneve realizohet pas miratimit të rekomandimit të komisionit nga organi kompetent.

Neni 25

Kriteret dhe dokumentacioni për subvencionet për mbulimin e shpenzimeve të varrimit

A) Kriteret

Për të përfituar subvencionin për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, aplikuesi duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Personi i ndjerë të ketë pasur vendbanim në Komunën e Junikut;
2. Varrimi të jetë kryer në varrezat e qytetit të Junikut (Rogopeq);
3. Aplikuesi të jetë anëtar i familjes së të ndjerit ose person i cili ka bartur shpenzimet e shërbimeve të varrimit;
4. Të paraqesë kërkesën brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e vdekjes;
5. Për të njëjtin rast të vdekjes dhe varrimit të mos jetë përfituar më parë subvencion nga Komuna e Junikut.

B) Dokumentacioni

Për aplikim për subvencion, aplikuesi duhet të dorëzojë:

1. Kërkesën për subvencion;
2. Kopjen e dokumentit të identifikimit të aplikuesit;
3. Certifikatën e vdekjes së të ndjerit;
4. Dëshminë e vendbanimit të të ndjerit, nëse vendbanimi nuk mund të verifikohet përmes regjistrave zyrtarë;
5. Dëshminë e lidhjes familjare me të ndjerin, në rast se aplikuesi është anëtar i familjes;
6. Dëshminë se varrimi është kryer në varrezat e qytetit të Junikut (Rogopeq), të lëshuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Inspektionit, Mbrojtjes dhe Shpëtimit;
7. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;
8. Konfirmimin e regjistrimit të xhirollogaritë bankare të aplikuesit në platformën e-Kosova;
9. Dokumente të tjera të nevojshme për verifikimin e kërkesës.

Neni 26

Subvencionet për kulturë, rinë, sport

1. Komuna mund të ndajë subvencione për kulturë, rinë dhe sport duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:

- 1.1. Klubet sportive;
- 1.2. Sportistët e dalluar;
- 1.3. Garat sportive;
- 1.4. Shoqëritë amatore (ansamblët);
- 1.5. Teatrot amatore;
- 1.6. Festivalet;
- 1.7. Botimi i librave;
- 1.8. Ekspozitat me fotografi;
- 1.9. Aktivitete me karakter garues;
- 1.10. Pjesëmarrje në festivale jashtë komunës;
- 1.11. Promovim i librave;
- 1.12. Promovim i talenteve të rinjve;
- 1.13. Aktivitete kulturore, rinore dhe sportive të organizuara nga DKRS;
- 1.14. KVRI;
- 1.15. Qendra Rinore.

2. Gjatë ndarjes së subvencioneve, në kushte të barabarta, Komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:

- 2.1. Projektet që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta sipas vlerës;
- 2.2. Projektet të cilat mund të krijojnë të hyra financiare për kërkuesin e subvencionit, në funksion të sigurimit të qëndrueshmërisë së projektit për periudhën e ardhshme; dhe
- 2.3. Aplikuesve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga Komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues të një subvencioni për kulturë, rini, sport të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

3. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve përfshijnë, por duke mos u kufizuar:

- 3.1. Projekt-propozimi;
- 3.2. Aplikacioni;
- 3.3. Dokumenti identifikues;
- 3.4. Certifikata e vendbanimit (për persona fizik);
- 3.5. Certifikata e regjistrimit (për persona juridik);
- 3.6. Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
- 3.7. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (për persona fizik);
- 3.8. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik);
- 3.9. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;
- 3.10. Konfirmimin e regjistrimit të xhirollogarisë bankare të aplikuesit në platformën e-Kosova.

Neni 27

Raportet kthyes nga përfituesit e subvencioneve

1. Përfituesit e subvencioneve të ndara nga Komuna me të cilët lidhet Marrëveshja obligohen që të dorëzojnë raporte financiare dhe narrative.
2. Përfituesit e subvencioneve obligohen që, pas marrjes së subvencionit, të dorëzojnë në Komunë raportin me të gjitha shpenzimet financiare, ashtu siç janë kërkuar me projekt-propozim. Raporti duhet t'i ketë të gjitha shpenzimet me dokumentacionin përkatës (raportet bankare, fatural e rregullta, nënshkrimet e pjesëmarrësve etj.).
3. Përfituesit e subvencioneve obligohen që, pas përfundimit të aktiviteteve, të dorëzojnë raportin narrativ, i cili duhet të ketë të gjitha detajet e aktiviteteve që janë realizuar gjatë periudhës së subvencionimit.
4. Periudha kohore e raportimit duhet të jetë 15 ditë të punës pas përfundimit të afatit të përcaktuar në marrëveshjen për subvencionim.
5. Raportet nga paragrafi 1 i këtij neni protokollohen dhe një kopje e tyre dorëzohet në arkivin e Komunës.

Neni 28

Monitorimi i përfituesve të subvencioneve

1. Komuna ka të drejtë të kërkojë nga përfituesi informacione dhe dëshmi për shpenzimin e mjeteve të përfituara nga subvencioni, brenda 10 ditëve nga kërkesa e Komunës.
2. Komuna mund të bëjë monitorimin e përfituesve të subvencioneve, me theks të veçantë te përfituesit në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik, në lidhje me shfrytëzimin e drejtë dhe sipas vendimit apo marrëveshjes të mjeteve të ndara në formë të subvencioneve.
3. Monitorimi sipas paragrafit 2 mund të bëhet më së paku një periudhë kohore prej 3 vjetësh nga data e përfitimit të subvencionit.

Neni 29

Transparenca në ndarjen e subvencioneve

1. Komuna publikon listën përfundimtare të përfituesve të subvencioneve brenda 5 ditëve të punës pas vendimit për ndarje të subvencioneve nga Kryetari.
2. Lista përfundimtare e përfituesve duhet të përmbajë: emrin e përfituesit, rastin, fushën për të cilën jepet subvencioni dhe shumat që iu janë ndarë.
3. Publikimi i të dhënave për përfituesit e subvencioneve bëhet në ueb-faqen e Komunës, në tabelat e shpalljeve si dhe në vendet e frekuentuara në territorin e Komunës.

Neni 30

Dispozitat tranzitore dhe shfuqizuese

1. Procedurat për ndarjen e subvencioneve të filluara para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje përfundojnë në përputhje me dispozitat e rregullores në fuqi në kohën e fillimit të procedurës.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, e miratuar më datës 31.10.2018, me nr. prot. 02-180-9082.

Neni 31
Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore i nënshtrohet shqyrtimit të ligjshmërisë dhe hyn në fuqi më 1 janar 2027.

Datë: 00.00.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Leonard Llojuni
